



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “PERKUSION”
ofruar nga
“UNIVERSITETI I ARTEVE”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr.Sonia Jojic

Dr. Dorina Arapi

Korrik/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Perkusion” ofruar nga Universiteti i Arteve

Nr.		
1	IAL aplikues:	“Universiteti i Arteve”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Muzikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Perkusion”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 381, datë 08.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 (kredite) ECTS
11	Forma e studimit:	Kohëe plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2024-2025:19 PAE/8 PAK V.a 2023-2024:Nuk është hapur Bachelor në “Perkusion”. V.a 2022-2023:17 PAE/7PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023: 3 studentë V.a 2023-2024: 0 studentë V.a 2024-2025: 2 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vendimi Nr. 145, datë 10.03.2021, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, të Universitetit të Arteve (UART) vlerësohet si një hap pozitiv në mbështetje të arsimit dhe kulturës artistike në Shqipëri. Ky status paraqet disa aspekte pozitive, por gjithashtu reflekton kufizime dhe sfida në vlerësimin e arsimit të lartë me formim artistik.

Ky vendim reflekton faktin se mësimdhënia dhe kërkimi në art nuk ndjekin të njëjtat kritere si shkencat tradicionale. Specifikisht, Paragrafi i nenit nr. 2 përmban një njohje zyrtare të natyrës së veçantë të arsimit artistik. Dhënia e një statusi të veçantë për veprimtarinë e UART-it e dallon këtë universitet nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, duke e legjitimuar specifikën e prodhimit artistik si një formë e vlefshme e kërkimit dhe e performancës akademike.

Termi “aktivitet kërkimor artistik-shkencor” është i gjerë, i paqartë dhe evaziv, gjë që sjell pasiguri dhe mund të çojë në interpretime të ndryshme. Kjo e vështirëson më tej zbatimin, për shkak të mungesës së standardeve kombëtare për vlerësimin e artit si kërkim shkencor.

Paragrafi 2. ku cilësohet: “*Statusi i veçantë i jepet UART-it për trajtimin e veçantë për efekt mësimdhënieje, veprimtarie akademike, të organizimit akademik dhe administrativ, të organizimit të programeve të studimit, të organizimit të aktivitetit kërkimor artistik-shkencor, të njohjes së aktivitetit artistik si pjesë e aktivitetit shkencor, që shërben për të vlerësuar performancën akademike vjetore, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it e të legjislacionit në fuqi*”, njeh me të drejtë natyrën hibride të mësimdhënies dhe kërkimit në fushën e arteve dhe përpiqet të përshtasë strukturën ligjore ndaj fushave të artit. Megjithatë, ai mbetet shumë i përgjithshëm dhe pa mekanizma të qarta kontrolli dhe vlerësimi, gjë që krijon probleme nëse nuk shoqërohet me standarde të qarta dhe mekanizma vlerësimi objektiv.

Paragrafi 8. Pika.a, cilëson: “*UART-i gëzon status të veçantë lidhur me: a) organizimin e programeve të studimeve në tri cikle të njëpasnjëshme që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave përkatëse. Programet e studimeve në UART hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik*”, përforcon autonominë dhe fleksibilitetin e Universitetit të Arteve në strukturimin e ofertës së tij akademike, duke i dhënë një autonomi akademike institucionit mbi hartimin e programeve nga njësitë bazë, çka i jep mundësi vetë komunitetit akademik të përcaktojë përmbajtjen e studimeve, në përputhje me zhvillimet artistike dhe kërkesat e tregut.

Por, pavarësisht këtij statusi të veçantë, që i përket Vendimit Nr. 145, datë 10.03.2021, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, si edhe duke u bazuar në vendimin e mëparshëm VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, UART, për vetë natyrën specifike që ka si institucion i lartë arsimor, paraqet vështirësi për t’ju përshtatur kërkesave specifike që kanë universitetet e tjera me orientim shkencor. Si rrjedhim, pa një kuadër të unifikuar kombëtar për arsimin artistik, të zgjeruar edhe të detajuar, të konceptuar specifikisht për këto programe studimi, vështirëson vlerësimin e tyre nga ekspertët e jashtëm, nga ASCAL, si edhe nga vetë institucioni për t’ju përshtatur një qasjeje apo metodologjie që nuk është pjesë e kërkimit artistik.



Ky status i veçantë është një hap pozitiv, por do të ishte e dobishme që të përfshiheshin edhe udhëzime për harmonizimin e programve në UART, duke i bërë këto programe më të integrueshme globalisht, por edhe në mënyrë që kërkimi artistik të afrohet dhe të bashkëjetojë me atë shkencor. Mungesa e një kuadri të qartë për sigurimin e cilësisë dhe harmonizimin ndërinstitutional e bën këtë status të veçantë jo të qëndrueshëm, nëse nuk shoqërohet me disa mekanizma vlerësimi të standardizuar specifik për arsimin e lartë artistik të nivelit 6 të kualifikimit.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Perkusion" ofrohet nga Departamenti i Interpretimit, në kuadër të Fakultetit të Muzikës, pranë Universitetit të Arteve. Hapja e këtij programi është miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 381, datë 08.07.2022.

Programi Bachelor në "Perkusion" realizohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me një kohëzgjatje prej tre vitesh akademike dhe përfshin një ngarkesë studimi prej 180 kreditesh ECTS. Ky program paraqet një zhvillim të ri në ecurinë akademike të Fakultetit të Muzikës dhe plotëson nevojat për thellimin profesional të studentëve, jo vetëm në aspektin teknik dhe interpretativ, por edhe në formimin e tyre si artistë krijues dhe studiues të muzikës.

Përmes këtij programi, kanë mundësinë të fitojnë kompetenca të avancuara profesionale dhe artistike, të zhvillojnë aftësi për krijimin dhe përvetësimin e njohurive të reja, si dhe të aplikojnë metoda bashkëkohore në aktivitetin e tyre artistik dhe interpretativ.

Programi mbështetet nga një trupë akademike me eksperiencë të konsoliduar në fushën e interpretimit dhe krijimtarisë muzikore, me kontribute të njohura në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nëpërmjet këtij programi, synohet gjithashtu thellimi personal i studentëve në disiplinën e përzgjedhur dhe nxitja e ndërveprimit ndërdisiplinor me programet e tjera të studimit, duke zgjeruar horizontet akademike dhe krijuar ura bashkëpunimi mes disiplinave të ndryshme artistike.

Diplomantët e këtij programi mund të punojnë në institucione të ndryshme të kulturës dhe artit, duke pasur mundësinë për t'u angazhuar në orkestrat dhe grupe të perkusionit. Për shkak të mungesës së një programi të specifikuar për perkusionin, ka një mundësi të madhe për diplomantët për të gjetur mundësi punësimi në institucione kulturore, si orkestrat simfonike, orkestrat frymore të institucioneve qendrore dhe lokale, shkollat artistike dhe ansamblet muzikore. Studentët e këtij programi mund të angazhohen gjithashtu në orkestrat dhe ansamblet e institucioneve të ndryshme qendrore dhe lokale.

Programi i diplomimit në fushën e perkusionit ofron mundësi të shumta për zhvillimin e studentëve dhe angazhimin e tyre në institucione kulturore dhe edukative. Disa nga mundësitë që përmendim janë:

a) Të diplomuarit në programin e perkusionit kanë mundësi të punojnë si instrumentistë të perkusionit në një treg të gjerë të kulturës, duke kontribuar në orkestrat dhe ansamblet e ndryshme. Ky sektor ofron mundësi të pasura punësimi në institucione të ndryshme kulturore dhe edukative.

b) Mungesa e një programi specifik studimi ka krijuar një hapësirë të gjerë për diplomuarit, të cilët mund të angazhohen në institucionet qendrore dhe lokale kulturore si orkestrat e TKOB-së, RTSH-së, orkestra simfonike, orkestrat frymore të bashkive, shkollat artistike dhe grupe




muzikore të muzikës klasike dhe moderne. Ky sektor është i pasur dhe ofron mundësi të shumta për të punuar dhe zhvilluar karrierën.

c) Angazhimi i studentëve në vitin e dytë të studimeve është një mundësi shumë e vlefshme, pasi ata mund të bëhen pjesë e orkestrave dhe ansambleve të institucioneve kulturore dhe edukative, duke fituar eksperiencë praktike që do t'i ndihmojë në zhvillimin e karrierës së tyre profesionale.

d) Zhvillimi i Liceve Artistikë është një mundësi për të pranuar nxënës në degën e perkusionit dhe për t'u ofruar atyre një arsimin të thelluar dhe mundësi për t'u angazhuar në aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike.

Këto mundësi krijojnë një platformë të pasur për zhvillimin profesional të studentëve dhe diplomuarve në fushën e perkusionit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.

Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në Fakultetin e Muzikës u zhvillua gjatë dy ditëve, më 17 dhe 18 shkurt 2025. Aktivitetet nisën me një takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, ku u diskutua mbi ecurinë dhe organizimin e vizitës, së bashku me Koordinatorin Teknik të ASCAL-it dhe Koordinatorin Institucional.

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të angazhuar nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Dr.Sonia Jojic Dr. Dorina Arapi.Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga koordinatoeja teknike e ASCAL, Msc. Alma Arapi.

Më pas u zhvillua një takim me Dekanin e Fakultetit të Muzikës dhe Përgjegjësin e Departamentit të Interpretimit, ku u trajtuan çështje që lidhen me strukturën, funksionimin dhe zhvillimet në departament. Vijoi takimi me përfaqësuesit e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për të dy programet e studimit që ishin objekt i vlerësimit. Më tej, u mbajt një takim me stafin akademik të angazhuar në këto programe, si me ata me status efektiv, ashtu edhe me të angazhuarit me kontratë.

Pas një pushimi të shkurtër për drekë pune, grupi u takua me studentët e të dy programeve të studimit, për të dëgjuar opinionet dhe përvojat e tyre lidhur me procesin mësimor dhe përmbajtjen e programeve. Më vonë, u realizua një takim me përfaqësues të sektorëve përgjegjës për çështjet mësimore dhe kurrikulare, informimin dhe këshillimin e studentëve, si dhe me përfaqësues të rrjetit të ish-studentëve (Alumni). Dita e parë u përmbyll me një vizitë në sekretarinë mësimore dhe një takim përmbyllës të shkurtër mes palëve pjesëmarrëse.

Në ditën e dytë, aktivitetet nisën me një tjetër takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, për të përgatitur vijimin e punës. Më pas u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku u diskutua mbi mekanizmat dhe dokumentacionin e brendshëm të cilësisë në institucion. Vizita vijoi me një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, si dhe me Zyrën e Projekteve Artistike dhe Shkencore, ku u diskutua mbi përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte të ndryshme. Në pjesën e dytë të ditës u realizua një vëzhgim i mjediseve të fakultetit, duke përfshirë auditorët, laboratorët, bibliotekën dhe shërbimet mbështetëse për studentët. Vizita u përmbyll me një takim me Përgjegjësin e Departamentit, ku u ndanë përshtypjet, u prezantuan gjetjet dhe u përmbyll procesi i vlerësimit për këtë fazë.



GVJ, pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft-raportin, sqaron si vijon:

Lidhur me komentet në **Fushën II, Standardi II.3, Kriteri 4**, të paraqitura nga Universiteti i Arteve të Tiranës (UART), GVJ rithekson se, ashtu siç është sqaruar edhe në hartimin e raportit, statusi i veçantë i këtij universiteti, i parashikuar në VKM nr. 145, datë 10.03.2021, përbën një element me rëndësi për funksionimin dhe ecurinë e UART. Megjithatë, ky status paraqet edhe sfida të veçanta në raport me disa aspekte të organizimit akademik dhe të dokumentacionit mbështetës.


Në bazë të raportit të vlerësimit të brendshëm dhe të dokumentacionit të paraqitur nga UART, rezulton se syllabuset, si ato të lëndëve speciale/artistike, ashtu edhe ato të lëndëve teorike, nuk janë hartuar sipas formatit të kërkuar nga udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit.

Për këtë arsye, GVJ sugjeron që:

- Çdo lëndë teorike, pjesë e kurrikulës së programit të studimit BSc në Perkusion, të përpilohet sipas kërkesave ligjore, duke përfshirë literaturën për çdo javë mësimore, në përputhje me temat e trajtuara në leksione.
- Ndërsa për lëndët speciale/artistike, literatura të paraqitet e gjitha në pjesën e literaturës së detyruar dhe të rekomanduar, pa ndarje javore, duke marrë parasysh natyrën e tyre të veçantë.

GVJ dakordëson ndryshimin e pikëvlerësimit për këtë standard, por rekomandon që në vijim të veprohet sipas udhëzimeve të mësipërme, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe të një standardizimi të dokumentacionit akademik.

Në lidhje me **Fushën III, Standardi III.4, Kriteri 5**, të paraqitura nga Universiteti i Arteve të Tiranës (UART), GVJ rekomandon që të merren masa konkrete në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura, në veçanti për lëndët teorike të këtij programi. Zbatimi i kësaj mase do të kontribuonte në rritjen e nivelit shkencor dhe zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë kërkimore brenda departamentit.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Bachelor në Perkusion ”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Arteve në Tiranë përfaqëson institucionin e vetëm publik të arsimit të lartë artistik në Shqipëri, i cili ofron programe studimi në fushat e Muzikës, Arteve të Bukura dhe Arteve Skenike. Në vitin 2022, në kuadër të Departamentit të Interpretimit pranë Fakultetit të Muzikës, u hap programi i ri i studimeve universitare Bachelor në “Perkusion”. Krijimi i këtij programi konsolidon misionin akademik dhe kombëtar të universitetit, duke zgjeruar gamën e specializimeve instrumentale dhe duke promovuar vlerat e diversitetit kulturor, si dhe synon të ruajë, zhvillojë dhe promovojë trashëgiminë muzikore kombëtare dhe evropiane. http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=5&niveli=18 <i>Evidencë Nr. 1.0.1 Statuti i UART.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.2 VKM Nr 145 datë 10.03.2021 Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si Institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.3 Urdhër i MAS me nr. 381 dt 08.07.2022 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Perkusion në Universitetin e Arteve.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.4 VKM nr. 234, datë 23.03.2011 “Për krijimin e Universitetit të Arteve”</i> <i>Evidencë Nr. 1.11 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025”.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Perkusion” në Universitetin e Arteve në Tiranë përfaqëson një zhvillim strategjik në kuadër të përmbushjes së misionit akademik dhe kulturor të institucionit, duke reflektuar një qasje të vetëdijshme ndaj nevojave të tregut artistik bashkëkohor si dhe aspiratave për forcimin e rolit të universitetit si një qendër e formimit të specializuar në fushën e muzikës. Struktura e këtij programi bazohet në një model pedagogjik që synon përgatitjen gjithëpërfshirëse të instrumentistëve të perkusionit, të aftë për të vepruar në një gamë të gjerë kontekstesh të jetës muzikore profesionale, përfshirë formatet solistike, ansamblet e muzikës

	së dhomës dhe orkestrat simfonike. Thelbi i programit qëndron në ndërthurjen organike të komponentëve teorikë me praktikën interpretative, duke u mbështetur në standarde bashkëkohore të arsimit të lartë artistik dhe në metodologji që favorizojnë zhvillimin progresiv të kompetencave akademike dhe performuese. Në këtë kuptim, programi synon jo vetëm zhvillimin e aftësive individuale në interpretimin e instrumenteve të perkusionit, por edhe kultivimin e kapaciteteve për bashkëpunim artistik në kuadër të punës në grup, çka përbën një parakusht për funksionimin efektiv në ansamble profesionale dhe struktura orkestrale. Përmes këtij formimi të integruar, programi kontribuon në dinamizimin e jetës artistike në nivel kombëtar dhe në promovimin e pranisë së interpreteve shqiptarë në skenat muzikore ndërkombëtare, duke afirmuar rolin e Universitetit të Arteve si një institucion kyç në zhvillimin dhe ndërkombëtarizimin e kulturës muzikore shqiptare. <i>Evidencë Nr. 1.11 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025".</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.3 Urdhër i MAS me nr. 381 dt 08.07.2022 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Perkusion në Universitetin e Arteve.</i> <u>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=5&niveli=18</u>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" në Universitetin e Arteve është konceptuar dhe implementuar në përputhje të plotë me Planin Strategjik 2018-2025 të institucionit, të miratuar nga Bordi Administrativ. Hartimi i tij mbështetet në kuadrin ligjor të arsimit të lartë në Shqipëri, konkretisht në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë" dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 145, datë 10.03.2021, që njeh statusin e veçantë të Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik në fushën e arteve në vend. <i>Evidencë Nr. 1.0.1 Statuti i UART.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.2 VKM Nr 145 datë 10.03.2021 Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si Institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.3 Urdhër i MAS me nr. 381 dt 08.07.2022 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Perkusion në Universitetin e Arteve.</i> <i>Evidencë Nr. 1.11 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025".</i>

Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Muzikës pranë Universitetit të Arteve përfaqëson një institucion me një traditë të konsoliduar në fushën e arsimit të lartë artistik, duke akumuluar më shumë se gjashtë dekada përvojë në përgatitjen e specialistëve të muzikës dhe duke ndërtuar një profil të njohur dhe të qëndrueshëm në peizazhin akademik dhe kulturor shqiptar. Kjo përvojë historike përbën një themel të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, përfshirë programin Bachelor në "Perkusion", i cili gëzon mbështetjen e një trupe akademike me ekspertizë të gjerë në fushën e interpretimit dhe krijimtarisë muzikore. Ky staf akademik, që ndërthur përvojën pedagogjike me aktivitetin artistik të mirëfilltë në skenat kombëtare dhe ndërkombëtare, garanton një proces formimi të orientuar drejt cilësisë dhe përputhjes me kërkesat bashkëkohore të zhvillimit artistik. <i>Evidencë Nr. 1.0.1 Statuti i UART</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Muzikës, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program, ka si objektiv zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimit artistik e shkencor, në përputhje me Kodet e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë. Fakulteti i Muzikës realizon aktivitetin e tij në fushën kryesore të Arteve dhe Shkencave Humane (kodi 02), në fushën e përgjithshme të Arteve (kodi 021), dhe në fushën specifike të Muzikës dhe Arteve Performuese (kodi 0215). Programi Bachelor në "Perkusion" është ndërtuar në përputhje të plotë me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Standardet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG 2015). <i>Evidencë Nr. 1.0.3 Urdhër i MAS me nr. 381 dt 08.07.2022 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Perkusion në Universitetin e Arteve.</i> <i>Evidencë Nr. 1.12 Udhëzuesi për Standardet e Sigurimit të Cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (European Standards and Guidelines – ESG 2015).</i>
Konkluzione	<i>UART ofron programe studimi që janë të përputhshme me misionin dhe qëllimin e tij strategjik. Këto programe zhvillohen në përputhje me fushën akademike të njësive përkatëse përgjegjëse, si dhe në harmoni me prioritetet kombëtare në fushën e arsimit, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Përmbajtja e programeve pasqyron ruajtjen dhe promovimin e vlerave kombëtare, kulturore dhe gjuhësore,</i>

	duke siguruar një qasje të integruar ndaj zhvillimit akademik dhe profesional të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Çdo vit akademik, Fakulteti i Muzikës pranë Universitetit të Arteve ndërmerr një proces të rregullt reflektimi dhe analize mbi çështjet thelbësore që lidhen me funksionimin e njësive bazë akademike, përfshirë zhvillimin e mësimdhënies, shpërndarjen e ngarkesës mësimore ndërmjet stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe rolin e personelit ndihmës akademik dhe administrativ në mbështetjen e proceseve institucionale. Këto analiza shërbejnë si bazë për hartimin dhe zbatimin e strategjive që synojnë përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve kyç në përmbushjen e objektivave akademike, artistike dhe institucionale të Fakultetit. Në këtë kuadër, njësitë mbështetëse luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e proceseve mësimore dhe të veprimtarive kërkimore-artistike, duke vepruar në koordinim të ngushtë me strukturat akademike për të garantuar një zhvillim të harmonishëm dhe efektiv të jetës universitare në kuadër të misionit të Universitetit të Arteve të Tiranës.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Universiteti i Arteve (UART) ka zhvilluar dhe vazhdon të mbajë bashkëpunime të ngushta me institucione arsimore dhe artistike kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto bashkëpunime shpesh formalizohen përmes marrëveshjeve dypalëshe, që ofrojnë mbështetje për aktivitete akademike dhe artistike. Disa nga institucionet me të cilat UART ka bashkëpunime janë: • Ministria e Kulturës e Shqipërisë; • Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë; • Conservatoire National Supérieur de Musique et de Danse de Paris (Francë); • Festivalin e Filmit CINEDAYS në Shkup (Maqedoni); • Zhejiang Normal University (Kinë); • Universiteti i Arteve të Bukura "Mimar Sinan" (Turqi).

	Ky rrjet bashkëpunimesh ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programeve studimore dhe ka zgjeruar mundësitë për zhvillimin e studentëve dhe pedagogëve në nivel ndërkombëtar. Gjithashtu, Universiteti i Arteve ka thelluar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes lidhjes së marrëveshjeve ndër-institucionale me nëntë institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, duke synuar promovimin e mobilitetit akademik në fusha të ndryshme të artit dhe teknologjive krijuese. Në kuadër të programit Erasmus+, janë vendosur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione prestigjioze në Spanjë, përfshirë: • Konservatorin e Lartë të Muzikës "Aldo" në Vigo; • Shkollën e Imazhit dhe Tingullit Audiovizual në Vigo; • Shkollën e Imazhit dhe Tingullit në La Korunja. Këto marrëveshje synojnë të krijojnë mundësi konkrete për shkëmbime studentore dhe bashkëpunime akademike në fushat e muzikës, arteve pamore, dizajnit dhe teknologjive audiovizive, duke kontribuar në ndërkombëtarizimin e arsimit artistik dhe në rritjen e përvojës profesionale të studentëve. <i>Evidenca Nr. 1.13 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i Departamentit të Interpretimit.</i> <i>Evidencën Nr. 1.14 UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" në Universitetin e Arteve ka një qasje të strukturuar dhe të orientuar drejt zhvillimit të praktikave profesionale dhe artistike të studentëve. Marrëveshjet e realizuara me institucione të ndryshme, përfshirë ato homologe dhe Zyrtat Vendore Arsimore, janë të rëndësishme për të ofruar mundësi të vlefshme për studentët në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale. Këto bashkëpunime sigurojnë një mjedis praktik të përshtatshëm, duke mundësuar që studentët të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve në kontekste reale. Një aspekt pozitiv i këtyre marrëveshjeve është se ato janë një mjet efektiv për t'u siguruar që studentët të kenë mundësi të përfshihen në aktivitete praktike dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në një mjedis të mbështetur. Në kuadër të këtij programi, studentët zhvillojnë praktikën profesionale/artistike nëpërmjet aktiviteteve dhe koncerteve të realizuara si brenda universiteteve ashtu edhe jashtë tij. Aktivitetet e realizuara nga Universiteti i Arteve, ose ato në partneritet me institucione dhe organizata të tjera, synojnë të ofrojnë mundësi reale për praktikën profesionale dhe artistike të studentëve.

	Disa aktivitete të realizuara gjatë vitit 2024: • Koncerti i Orkestrës Simfonike të studentëve të UART, • Koncerti i klasës së tunxhit, • UART Big Band Live, • Koncert me krijimtarinë e kompozitorit Prof. Dr. Isak Shehu, • Koncerti i Eastern Balkans Youth Orchestra, • Konkursi Ndërkombëtar "Ymer Skënderi" Gjithashtu, Universiteti i Arteve (UART), në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Tiranë dhe Fakultetin e Muzikës, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me synimin për të institucionalizuar procesin e zhvillimit të praktikës mësimore nga studentët e Fakultetit të Muzikës pranë institucioneve arsimore parauniversitare publike në qytetin e Tiranës. Kjo marrëveshje ka për qëllim përmbushjen e detyrimeve akademike të studentëve në kuadër të programeve të studimit të nivelit "Bachelor" dhe "Master", duke u ofruar atyre mundësinë për të zhvilluar përvojë praktike profesionale në mjedise të përshtatshme dhe të mbështetura nga institucionet arsimore. <i>Evidenca Nr. 1.13 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i Departamentit të Interpretimit.</i> <i>Evidenca Nr. 1.15 Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Muzikës me ZVA-në për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve.</i> <i>Evidencë Nr. 1.16 Foto - video, artikuj, Festivale; postera.</i> <i>Evidencë Nr. 1.17 Raport mbi marrëveshjet e bashkëpunimit.</i> <i>Evidencë Nr. 2.13 Masterklase, workshope.</i> <i>Evidencë Nr. 2.14 Koncerte, festivale, aktivitete.</i> <i>Evidencë Nr. 2.15 Të dhëna mbi aktivizimin e studentëve që po frekuentojnë programin e studimit "Perkusion".</i> <i>Evidencë Nr. 2.16 Projektet Artistike të Programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Interpretimit, në bashkëpunim të ngushtë me Dekanatin organizon mbledhje për të diskutuar dhe analizuar marrëdhëniet e bashkëpunimit ekzistuese. Departamenti harton raporte analitike që shërbejnë si bazë për përmirësimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe realizimin e suksesshëm të programit Bachelor në "Perkusion". Kjo qasje proaktive ndihmon në zhvillimin e një strategjie të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca Nr. 1.13 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i Departamentit të Interpretimit.</i>

	Evidencë Nr. 3.0.9 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2022-2023			
Konkluzione	Universiteti i Arteve (UART) siguron dhe zhvillon marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione arsimore, kompani, organizata partnere, si dhe me aktorë të biznesit vendas dhe/ose ndërkombëtar. Këto marrëdhënie kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin dhe mbështetjen e programeve të studimit, duke u fokusuar në aftësimin profesional të studentëve, nxitjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe promovimin e mobilitetit akademik. Marrëveshjet dhe iniciativat konkrete të bashkëpunimit përbëjnë dëshmi të qarta të angazhimit të institucionit në rritjen e cilësisë dhe të ndikimit të tij në tregun e punës dhe komunitetin shkencor dhe kulturor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi	Programi i studimit BSC në "Perkusion" ofrohet nga Departamenti i Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, dhe është i strukturuar sipas Aktit Normativ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Ky program ka për qëllim zhvillimin e aftësive artistike dhe profesionale të studentëve, duke i përgatitur ata për të punuar në institucione kulturore dhe arsimore, si dhe në sektorin privat. Programi ofrohet me 180 ECTS, që janë të shpërndarë në aktivitete të ndryshme akademike dhe artistike. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet provimeve të formimit artistik, provimeve me gojë, vlerësimeve të detyrave dhe projekteve artistike, etj. Vlerësimi bëhet sipas sistemit të notës nga 1 deri në 10, ku nota 10 është vlerësimi maksimal dhe nota 5 është minimumi për kalimin e provimeve. Plani mësimor përbëhet nga lëndë të cilat janë të kategorizuara sipas udhëzimeve të MAS dhe përfshijnë:

dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	• Lëndë Bazë; • Lëndë Karakterizuese; • Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese; • Lëndë Plotësuese; • Detyrime Përmbyllëse (si përgatitja e koncertit të diplomës). <i>Programi është gjithashtu i publikuar në faqen online të universitetit.</i> http://uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Perkusion.pdf <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i> <i>Evidencë Nr. 2.0.2 Plani mësimor i programit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshmë e në një fushë të	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" ka si qëllim formimin e instrumentistëve të aftë për një karrierë të suksesshme në fushën e muzikës klasike dhe është dizajnuar për të përgatitur studentët për të përballuar dhe nevojat e tregut artistik dhe kulturor, duke u ofruar mundësi për karriera në: • Instrumentist solist; • Instrumentist në ansamblet e dhomës; • Instrumentist në orkestrat simfonike. Një tjetër qëllim i programit është që studentët, pas përfundimit të ciklit të parë, të kenë mundësi të vazhdojnë studimet edhe jashtë vendit, në programe të ngjashme në akademi arti të njohura ndërkombëtarisht. http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=193&niveli=87 <i>Evidencë Nr. 2.0.2 Plani mësimor i programit</i>

specializuar studimi ose profesionale.	
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Në programin e ciklit të parë Bachelor në "Perkusion", veprimtaritë formuese realizohen kryesisht në auditor, ku përveç lëndëve të parashikuara në planin mësimor, zhvillohen edhe lëndë speciale në instrument dhe muzikë dhome. Për çdo lëndë organizohen aktivitete të ndryshme si leksione, seminare, ushtrime, koncerte, workshop-e, masterclass-e, studim individual (si studim, punë kërkimore, detyra apo projekte artistike), përgatitje për provime dhe përgatitje të koncertit të diplomës, si dhe praktikë artistike. Shpërndarja e krediteve sipas kategorive është si vijon: Kategoria A - Lëndë Bazë Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme: 22 ECTS (12.5%) Kategoria B - Lëndë Karakterizuese Përgatitje për disiplinën shkencore: 105 ECTS (58%) Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese Nën disiplina, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje: 24 ECTS (13.5%) Kategoria D - Lëndë Plotësuese Gjuha të huaja, njohuri informatike, praktika artistike: 19 ECTS (10.5%) Kategoria E - Detyrime Përmbyllëse 10 ECTS (5.5%) Kategoria B përmban lëndët kryesore të studimit, të cilat janë të rëndësishme për formimin profesional dhe artistik të studentëve, ndërsa lëndët e tjera kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të nevojshme për karrierën e ardhshme të studentëve në fushën e muzikës. Shih: VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021; nr. 823, datë 28.12.2023) (i përditësuar) <i>Programi është gjithashtu i publikuar në faqen online të universitetit.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i> <u>http://www.uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Perkusion.pdf</u> Evidencë Nr. 2.0.2 Plani mësimor i programit
Kriteri 4. Programi i	Si rezultat i statusit të veçantë që ka përfutur institucioni, shpërndarja e ngarkesës në planin mësimor është realizuar duke u përshtatur me

studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	orientimet e dhëna në Tabelën 1 të Shtojcës 1 të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 185, datë 25.03.2021, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë." Përsa i përket praktikës artistike, ajo është pjesë e lëndëve të kategorisë D. Praktika artistike përfshihet në kategorinë D, së bashku me lëndët e gjuhëve të huaja dhe njohuri informatike. Ngarkesa për këto lëndë është .19 ECTS (10.5% e totalit të ngarkesës së përgjithshme). Praktika artistike zhvillohet në ambiente të ndryshme si UART, institucione artistike me status kombëtar dhe lokal, institucione të edukimit parauniversitar, rezidenca artistike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe produkte muzikore kombëtare dhe ndërkombëtare. Praktika artistike zhvillohet në ambiente të Universitetit të Arteve, si dhe në institucione artistike me status kombëtar dhe lokal, institucione edukimi parauniversitar, rezidenca artistike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në produksione muzikore të ndryshme, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kategoria E - Detyrimet Përmbyllëse, përfshin 5.5% të krediteve, që përkthehet në 10 ECTS, ku përfshin punën finale për marrjen e diplomës, dhe në rastin e programit "Perkusion", është Koncerti i Diplomës. <i>Evidencë Nr. 2.0.2 Plani mësimor i programit</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" në Universitetin e Arteve (UART) ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit dhe zgjat tri vite, duke mundësuar grumbullimin e 180 ECTS. Ky program është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore përkatëse dhe ofrohet në gjuhën shqipe. UART ka statusin e veçantë si institucion publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Shqipëri, sipas VKM Nr. 145. Programi realizohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UART. http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.16_dt.07.10.2021.PDF <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i>
Kriteri 6. Programet e studimit	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit, është i vetmi institucion që ofron programin e ciklit të parë, Bachelor në "Perkusion" në Shqipëri.

Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi Bachelor në "Perkusion" është pjesë e kodifikimit të programeve të studimit, sipas VKM nr. 330, 11.05.2022. Kodifikimi është ende në proces nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe do të përcaktohet pas përfundimit të tij.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" ofrohet nga Departamenti i Interpretimit, në kuadër të Fakultetit të Muzikës, dhe organizohet në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore kombëtare në fuqi. Struktura, përmbajtja dhe realizimi i programit respektojnë standardet akademike dhe kërkesat institucionale për arsimin e lartë artistik. Programi synon zhvillimin profesional të studentëve në fushën e interpretimit muzikor, në përputhje me misionin e Universitetit të Arteve dhe me nevojat e tregut artistik kombëtar dhe ndërkombëtar.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																					
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në “Perkusion” përbëhet nga artistë me përvojë të gjatë si në fushën e mësimdhënies, ashtu edhe në veprimtarinë artistike dhe kërkimore. Kjo përbërje garanton një nivel të lartë profesionalizmi dhe kompetencë në ofrimin e programit të studimit. Titujt dhe gradat akademike, dhe ngarkesa personelit të angazhuar për programin BSC. “Perkusion” për secilin vit akademik është si më poshtë: Fakulteti i Muzikës ku bën pjesë program i studimit BSC në “Perkusion” ka në përbërjen e tij për tri vite akademike staf si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Fakulteti i Muzikës</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.dr</td><td>2</td><td>4</td><td>1</td><td>3</td><td>2</td><td>4</td></tr><tr><td>Prof</td><td>14</td><td>3</td><td>12</td><td>5</td><td>10</td><td>4</td></tr><tr><td>Prof.Asc.Dr</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>5</td><td>4</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof.Asc</td><td>13</td><td>4</td><td>12</td><td>1</td><td>10</td><td>3</td></tr><tr><td>Dr/Doc</td><td>13</td><td>5</td><td>13</td><td>2</td><td>13</td><td>5</td></tr><tr><td>Msc</td><td>18</td><td>49</td><td>27</td><td>42</td><td>25</td><td>47</td></tr><tr><td>Lektor</td><td>19</td><td>-</td><td>14</td><td>-</td><td>14</td><td>-</td></tr><tr><td>Totali</td><td>82</td><td>65</td><td>82</td><td>58</td><td>78</td><td>65</td></tr></table> Departamenti i Interpretimit për tri vitet akademike ka në përbërjen e tij:	Fakulteti i Muzikës	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.dr	2	4	1	3	2	4	Prof	14	3	12	5	10	4	Prof.Asc.Dr	3	-	3	5	4	2	Prof.Asc	13	4	12	1	10	3	Dr/Doc	13	5	13	2	13	5	Msc	18	49	27	42	25	47	Lektor	19	-	14	-	14	-	Totali	82	65	82	58	78	65
Fakulteti i Muzikës	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																																	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																
Prof.dr	2	4	1	3	2	4																																																																
Prof	14	3	12	5	10	4																																																																
Prof.Asc.Dr	3	-	3	5	4	2																																																																
Prof.Asc	13	4	12	1	10	3																																																																
Dr/Doc	13	5	13	2	13	5																																																																
Msc	18	49	27	42	25	47																																																																
Lektor	19	-	14	-	14	-																																																																
Totali	82	65	82	58	78	65																																																																

	Tituj/Grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.dr	1	-	1	-	-	-
	Prof	10	1	10	1	10	1
	Prof.Asc.Dr	1	-	1	-	1	-
	Prof.Asc	10	2	10	2	10	2
	Dr/Doc	10	-	7	-	7	-
	Msc	2	33	5	26	5	25
	Lektor	15	-	15	-	15	-
	Totali	49	36	49	29	48	28
		Përbërja e stafit akademik në këtë program studimi është në përputhje me përqindjet e përcaktuara sipas normativave ligjore në fuqi për arsimin e lartë. <i>Evidencë Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 7)</i>					
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.		Në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pranë çdo njësie kryesore të Universitetit të Arteve funksionojnë struktura ndihmëse dhe mbështetëse me karakter akademik dhe administrativ. Këto struktura janë të përcaktuara në organigramën dhe në rregulloret përkatëse të secilës njësi. Personeli ndihmës akademik në Universitetin e Arteve përfshin dy kategori: atë me karakter mësimor-artistik/shkencor, i cili mbështet proceset mësimore dhe zhvillimin artistik e shkencor, dhe atë me karakter administrativ, që garanton funksionimin logjistik dhe teknik të veprimtarive akademike në të gjitha nivelet e institucionit. Pedagogët e brendshëm drejojnë praktikën artistike të studentëve të programit "Perkusion", duke i mbështetur në zhvillimin e aftësive të tyre artistike dhe performuese. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i>					
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe		Departamenti i Interpretimit është i organizuar në grupe mësimore që mbajnë përgjegjësi për zhvillimin e programit të studimit dhe sigurojnë përputhjen me objektivat e tij. Grupi mësimor funksionon si koordinues i procesit mësimor, duke siguruar organizimin e aktiviteteve mësimore dhe përfshirjen e pedagogëve dhe studentëve nga grupe të ndryshme, si Fryma, Harqet dhe Piano. Koordinatorët janë të ngarkuar për përmirësimin e mësimdhënies dhe zhvillimin e programit.					

zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Praktikës Artistike ka përgjegjësinë të udhëheqë dhe mbështesë veprimtaritë artistike dhe praktikat për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të studentëve. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i>			
Konkluzione	Departamenti i Interpretimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të përcaktuara për funksionimin dhe organizimin e tij. Struktura organizative, përbërja dhe kualifikimi i stafit akademik, kapacitetet infrastrukturore dhe shërbimet mbështetëse janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, si dhe me standardet përkatëse të akreditimit. Departamenti garanton funksionimin cilësor të programeve të studimit nën përgjegjësinë e tij dhe angazhohet në zhvillimin dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Interpretimit në Fakultetin e Muzikës në UART ka miratuar Rregulloren e Programit të Bachelor në "Perkusion", me VSA Nr. 94, datë 09.07.2024. Rregullorja përfshin informacion mbi planin mësimor, objektivat e programit, organizimin e praktikave profesionale artistike, pranimin e studentëve, dhe procedurat për regjistrim, mbrojtjen e diplomës, dhe lëshimin e suplementit të diplomës. Kjo rregullore përshkruan në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat dhe dispozitat që duhet të ndiqen gjatë zhvillimit të programit të studimit. Pjesë e saj janë dispozita të ndryshme që rregullojnë aspektet kyçe të organizimit të studimeve dhe administratës akademike, përfshirë: • Plani mësimor; • Organizimi i programit të studimit dhe objektivat e tij; • Programi mësimor i lëndëve; • Organizimi i praktikave artistike; • Pranimi i studentëve në programin e studimit të ciklit të parë;

	• Procedurat e përgjithshme dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në konkurs; • Mbrojtja e diplomës; vlerësimi dhe lëshimi i saj; <i>Evidencë Nr. 2.0.2 Plani mësimor i programit</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i> <i>Evidencë Nr. 2.0.8 Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve sipas planit mësimor.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" është organizuar në lëndë të cilat janë të vlerësuara në kredite. Plani mësimor është bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 dhe VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, si dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Ky program ka një kohëzgjatje prej tri vitesh akademike dhe përmban 180 kredite. Lëndët janë të ndara në semestra dhe përfshijnë aktivitete formuese si leksione, ushtrime, seminare, praktika artistike, etj. Ngarkesa në auditor dhe aktivitete si koncerti i diplomës janë gjithashtu të përfshira në shpërndarjen e krediteve. Objektivat për secilin modul janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse të lëndëve, të cilat miratohen nga Senati Akademik i UART pas propozimit nga Departamenti i Interpretimit dhe miratimit nga Dekani i Fakultetit të Muzikës. • A: Lëndë Bazë – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme. • B: Lëndë Karakterizuese – Përgatitje për disiplinën shkencore. • C: Lëndë Nderdisiplinore – Ndërdisiplina, profile dhe grupe lëndësh me zgjedhje. • D: Lëndë Plotësuese – Gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale. • E: Detyrimet Përmbyllëse. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të	Pranimi i kandidatëve në programin e studimeve Bachelor në "Perkusion" pranë Universitetit të Arteve realizohet nëpërmjet një konkursi të organizuar çdo vit akademik, në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati Akademik, e cila publikohet në mënyrë transparente në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i përzgjedhjes bazohet në kriteret artistike dhe akademike të përcaktuara qartë, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe

pranimi, transferimi dhe ekuivalentimi të studimeve.	përputhjes së kandidatëve me kërkesat e programit. Sa i takon transferimi të studentëve dhe njohjes së krediteve, këto procedura rregullohen nga kuadri ligjor në fuqi dhe nga aktet normative të brendshme të Universitetit të Arteve, duke u zbatuar në mënyrë të unifikuar për të gjithë studentët që kërkojnë të transferohen brenda programeve të të njëjtit cikël studimi ose të njihen për studime të kryera në institucione të tjera të arsimit të lartë. Vlerësimi i kërkesave për ekuivalentim dhe njohje të krediteve bëhet nga komisioni i specializuar pranë departamentit përkatës dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit të Muzikës, në përputhje me standardet akademike të institucionit. Të gjitha informacionet e detajuara mbi kriteret e pranimi, procedurat e transferimi dhe njohjen e krediteve janë të aksesueshme publikisht në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, duke garantuar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë kandidatët dhe studentët. http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=133&niveli=89 http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=13&niveli=90 <i>Evidencë Nr. 5.0.4 Miratimi i tarifave të konkurimit, të regjistrimit dhe të shkollimit për vitin 2022-2023.</i> <i>Evidencë Nr. 5.0.5 Daklarimi i kuotave të pranimi për vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Evidencë Nr. 5.0.7 VSA nr 11 dt 09.02.2023 mbi përcaktimi i pikëzimit në konkurset e pranimi. Evidencë Nr. 5.0.8 VSA nr. 12 dt. 09.02.2023 mbi propozimin për miratimin e tarifave të konkurimit, tarifës së regjistrimit, tarifës së shkollimit.</i> <i>Evidencë Nr. 5.22 Të dhëna të plota mbi numrin e studentëve të rregjistruar, në programin e studimit Bachelor "Perkusion" në tre vitet e fundit.</i> <i>Evidencë Nr. 5.23 Rregullore e funksionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</i> <i>Evidencë Nr. 2.0.7 Rregullore për zhvillim e konkursit të pranimi në programet "Bachelor" në fakultetin e Muzikës, në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2024-2025.</i> http://www.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=1022&niveli=85
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e	Programi mësimor i lëndës (syllabusi) hartohet nga drejtuesi i lëndës, i cili është titullari i saj. Në rast se nuk ka një të tillë, me propozim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe me urdhër të Dekanit, mund të përgatitet nga një grup i personelit akademik me kohë të plotë dhe më pas konsultohet me grupin përkatës mësimor pranë departamentit. Syllabuset janë hartuar duke u mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të

laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Arteve si Institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë". Pavarësisht kësaj, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, u konstatua se syllabuset nuk përmbajnë literaturën përkatëse për çdo temë leksioni. GVJ sugjeron që çdo syllabus të pasurohet me literaturën e nevojshme, të ndarë sipas temave që trajtohen në secilin leksion javor. Në shumicën e syllabuseve mungon referimi i literaturës përkatëse për çdo javë leksionesh, së bashku me specifikimin e faqeve që duhet të lexohen. Gjithashtu, në çdo syllabus duhet të përfshihen emri i pedagogut përgjegjës për lëndën si dhe adresa e tij/saj elektronike. Rekomandohet gjithashtu një unifikim i plotë i formatit dhe strukturës së të gjitha syllabuseve, për të siguruar një qasje të standardizuar dhe të qartë për studentët dhe stafin akademik. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i> <i>Evidencë Nr. 2.0.8 Plan i mësimor dhe syllabuset e lëndëve sipas planit mësimor</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Siç është e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit B.Sc. në "Perkusion", plani mësimor është objekt i rishikimit dhe vlerësimit periodik. Programi i studimit Bsc. në "Perkusion" është një program i ri, dhe deri me tani, programi i studimit "Perkusion" nuk ka pasur asnjë ndryshim, pasi ndodhet në vitin e parë të implementimit dhe kalon në proces akreditimi. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i>
Konkluzione	GVJ sugjeron që çdo syllabus të pasurohet me literaturën e nevojshme, të ndarë sipas temave që trajtohen në secilin leksion javor. Në shumicën e syllabuseve mungon referimi i literaturës përkatëse për çdo javë leksionesh, së bashku me specifikimin e faqeve që duhet të lexohen. Gjithashtu, në çdo syllabus duhet të përfshihen emri i pedagogut përgjegjës për lëndën si dhe adresa e tij/saj elektronike. Rekomandohet gjithashtu një unifikim i plotë i formatit dhe strukturës së të gjitha syllabuseve, për të siguruar një qasje të standardizuar dhe të qartë për studentët dhe stafin akademik. GVJ rekomandon që në vijim të veprohet sipas udhëzimeve të mësipërme, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe të një standardizimi të dokumentacionit akademik.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Lëndët e ofruara në programin BSC. "Perkusion" janë hartuar me qëllim të zhvillimit të njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve në fushën e artit, me fokus në Perkusion. Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit, së bashku me shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave, janë të strukturuar në mënyrë që të kontribuojnë në thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të studentëve. Kjo gjë siguron përgatitjen e studentëve për studime të mëtejshme dhe për mundësi punësimi, duke integruar elemente teorike dhe praktike që përmbushin kërkesat e tregut të punës dhe fushave akademike. Për shkak të mungesës së një programi të ngjashëm në treg, ky program i ofron studentëve mundësi të gjerë dhe të pambuluar më parë, për punësim në institucione kulturore qendrore dhe lokale, si dhe në sektorin privat. <i>Evidencë Nr. 1.0.0 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bsc. në Perkusion</i>
Kriteri 2. Lëndët/modul et, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të	Programi i studimit 'Perkusion' është një program trevjeçar, i ndarë në 6 semestra, i cili ka një total prej 180 kreditesh. Shpërndarja e lëndëve dhe struktura e tyre janë të përcaktuara në përputhje me parashikimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, dhe janë krijuar për të mundësuar realizimin e objektivave formues të programit. Kjo strukturë ofron mundësinë për arritjen e rezultateve të pritshme, si nga ana e studentëve, ashtu edhe nga aspekti i kërkimit artistiko-shkencor. Plani mësimor përfshin një kombinim të orëve mësimore në auditor, seminare dhe aktivitete jashtë klasës, të cilat janë të konceptuara për të përmbushur objektivat e caktuara. Ky plan ka si qëllim zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike të studentëve, duke kontribuar në përgatitjen e tyre të plotë për angazhimin në fushat profesionale dhe artistike. • A: Lëndë Bazë – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme. • B: Lëndë Karakterizuese – Përgatitje për disiplinën shkencore. • C: Lëndë Nderdisiplinore – Ndërdisiplina, profile dhe grupe lëndësh me zgjedhje.

prishme të të nxënit.	• D: Lëndë Plotësuese – Gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale. • E: Detyrimet Përmbyllëse. Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtar e.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" ka për qëllim ofrimin e njohurive të thelluara mbi instrumentin e perkusionit dhe zhvillimin e aftësive muzikore të studentëve, duke përfshirë aspektet teknike, artistike dhe estetike. Struktura e programit është e ndarë në disa module: • A: Lëndë Bazë – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme. • B: Lëndë Karakterizuese – Përgatitje për disiplinen shkencore. • C: Lëndë Nderdisiplinore – Ndërdisiplina, profile dhe grupe lëndësh me zgjedhje. • D: Lëndë Plotësuese – Gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale. • E: Detyrimet Përmbyllëse. Kurrikula është hartuar në përputhje me sistemet ndërkombëtare dhe parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), ku një kredit përkon me 25 orë pune të studentit. Programi ka një ngarkesë vjetore prej 60 krediteve, e cila është e balancuar gjatë gjashtë semestreve akademike. Përveç lëndëve të profilit, studenti gjithashtu merr njohuri mbi Folklorin Muzikor Shqiptar dhe mundësinë e integritimit në tregun e punës përmes lëndëve të menaxhimit dhe gjuhës angleze. Programi është gjithashtu i publikuar në faqen online të universitetit. Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion. Evidencë Nr. 2.0.2 Plani mësimor i programit http://ëëë.uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Perkusion.pdf
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik	Pavarësisht se në kurrikulën e programit, i jepet një përparësi lëndëve karakterizuese, me 105 ects, programi i studimit ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi dhe kompetenca që janë të domosdoshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës. Kurrikula e programit të studimit ndihmon studentët të zhvillohen jo vetëm në aspektin akademik, por edhe si profesionistë të aftë për të kontribuar në fushën e tyre të specializuar, duke krijuar mundësi për të kaluar nga teoria




mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	në praktikë dhe duke siguruar transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. <i>Evidencë Nr. 2.0.2 Plan i mësimor i programit</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset janë objekt i rishikimit periodik vjetor, të cilat udhëhiqen nga pedagogët e lëndëve, anëtarët e departamentit dhe përgjegjësi i departamentit. <i>Programi i studimit B.Sc. në "Perkusion" është një program i ri, dhe deri me tani, nuk ka pasur asnjë ndryshim, pasi ndodhet në vitin e parë të implementimit dhe kalon në proces akreditimi</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Perkusion" është konceptuar për të siguruar që studentët të fitojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e kërkuara, të cilat janë të pasqyruara qartë në objektivat dhe qëllimet e secilës lëndë të përfshirë në program. Kështu programi kontribuon në zhvillimin e aftësive për krijimin dhe performimin në këtë zhanër, i cili ka pasur ndikim të madh në muzikën moderne botërore. Fakulteti i Muzikës, si pjesë e Universitetit të Arteve, ofron programe të ndryshme studimi në fushën e muzikës dhe ky program është konceptuar për të mbuluar nevojat e tregut muzikor në Shqipëri dhe jashtë saj. <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i> <i>Evidencë Nr. 2.0.2 Plan i mësimor i programit.</i>





Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Për hartimin e programit të studimit Bachelor në "Perkusion", janë marrë parasysh kërkesat e tregut shqiptar, ku ka pasur një mungesë të instrumentistëve të perkusionit në orkestrat simfonike dhe ansamblet e dhomës. Diplomimi në këtë program u ofron studentëve mundësi punësimi në institucione kulturore, si orkestrat sinfonike dhe frymore, shoqatat muzikore dhe ansamblet, shkollat artistike, dhe sektori privat. Në përputhje me standardet evropiane, ky program është hapur për herë të parë dhe ka për qëllim të forcojë më tej profilin e tij dhe të rrisë bashkëpunimet, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. <i>Siç u shprehën stafi akademik dhe studentët e këtij programi, thellimi i njohurive në hapjen e studimeve Master në "Perkusion" për profilizimin në performancë dhe mësimdhënie, është e nevojshme. Gjithashtu, ata u shprehen se duke pasur parasysh që në arsimin parauniversitar është implementuar lënda "Perkusion", si dhe kërkesat për arsimtarët e lëndës "Muzikë" në shkollat nëntëvjeçare dhe specifikat e përshtatjes së programeve mësimore me muzikën bashkëkohore të preferuar nga brezat e rinj, formimi i plotë akademik i studentëve në "Perkusion" është i domosdoshëm.</i> Në këtë kuadër, drejtimi "Perkusion" përfaqëson një mundësi të veçantë, duke qenë se, për shkak të mungesës së një programi specifik deri më tani, ekziston një hapësirë e gjerë dhe ende e pambuluar për punësimin e të diplomuarve në këtë fushë. Kjo përfshin institucione kulturore në nivel qendror dhe lokal, si edhe sektorin privat, ku kërkesa për profesionistë të kualifikuar në perkusion është në rritje. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i>			
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit janë në përputhje me objektivat formues të secilit program, me nivelin përkatës të kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, si dhe me rezultatet e të nxënit dhe mundësinë për vazhdimin e studimeve. Programet sigurojnë zhvillimin e kompetencave të nevojshme profesionale dhe ndërdisiplinore, në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Interpretimit në Fakultetin e Muzikës fokusohet në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe adaptimin e tyre me kërkesat e tregut të punës. Ky proces përfshin aktivitete konsultative, duke mbledhur reagime nga studentët dhe të diplomuarit për të përshtatur kurrikulat me nevojat e industrisë muzikore. Objektivi kryesor është që programet të jenë konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke ofruar njohuri dhe aftësi që e përgatitin studentin për tregun e punës pas diplomimit. Ky proces bazohet në reflektimin dhe feedback-un e studentëve, në përputhje me metodat e mësimdhënies në përputhje me zhvillimet e fundit. <i>Gjatë bisedës me studentët e këtij programi, ata shprehën interes dhe kënaqësi për zhvillimin e tij, si dhe për marrëdhënien, konsultat dhe mendimet që u shkëmbyen gjatë vitit akademik me pedagogët e programit. Këtë gjë e konfirmuan të gjithë studentët, të pranishëm në bisedë. Ata shprehën se ky program është mëse i nevojshëm për çdo student që dëshiron të studiojë muzikë dhe të rritet profesionalisht.</i> Vizita në institucion
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Programi i studimit BSC në "Perkusion" ende nuk ka pasur diplomime, pasi brezi i parë i studentëve pritët të diplomohet në vitin akademik 2024-2025. Fakulteti i Muzikës, në bashkëpunim me Sektorin Mësimor, mbledh të dhëna për punësimin e të diplomuarve, duke ndjekur vazhdimisht ecurinë e tyre profesionale. Institucioni mban kontakte të qëndrueshme me ish-studentët, të cilët përfshihen në aktivitete mësimore dhe artistike brenda Universitetit të Arteve dhe në ngjarje të tjera jashtë tij. Kjo marrëdhënie e vazhdueshme ndihmon në forcimin e lidhjes mes diplomuarve dhe institucionit, si dhe kontribuon në zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit. Evidencë Nr. 3.22 Rregullorja e funksionimit të sekretarive mësimore të fakulteteve në Universitetin e Arteve. Evidencë Nr. 3.19 Kopje e regjistrit themeltar. Evidencë Nr. 3.20 Kopje e regjistrit të arritjeve Evidencë Nr. 3.21 Kopje e regjistrit të diplomave
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në	Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit, i kushton një rëndësi të madhe bashkëpunimit me institucione të ndryshme për të ofruar programe studimi që janë të sinkronizuara me nevojat e tregut të punës. Ky bashkëpunim ka si objektiv përgatitjen e studentëve me aftësi dhe dije të nevojshme për një karrierë profesionale të suksesshme. Aktivitetet kryesore të bashkëpunimit përfshijnë:

bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.

Bashkëpunime me institucione profesionale dhe kulturore:

- Radio Televizioni Shqiptar (RTSH),
- Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit,
- Institucione publike dhe private të tjera në fushën e muzikës.

Fakulteti i Muzikës ka realizuar bashkëpunime me festivale të rëndësishme, si:

- "Jazz in Albania",
- "Workshop Ethno Albania",
- "Gjon Mili Jan. & Blues Festival",
- "Albanian Brass Festival".

Gjithashtu, sipas raportit vjetor, dhe diskutimeve me stafin pedagogjik, në kuadër të festimeve për 60-vjetorin e Fakultetit të Muzikës, Departamenti i Interpretimit në Universitetin e Arteve, ka zhvilluar gjatë periudhës prill-qershor 2022 ka njohur një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 60 koncerte, me një pjesëmarrje prej rreth 90% të studentëve të Departamentit të Interpretimit, si dhe me angazhimin e pothuajse të gjithë pedagogëve së bashku me klasat e tyre. Aktivitetet kanë përfshirë koncerte recitale individuale, koncerte të klasave, performanca në komunitet, botime të CD-ve me realizime artistike dhe organizimin e festivaleve muzikore në shkallë kombëtare. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar përfshirjes së sa më shumë studentëve në këto aktivitete, duke u dhënë atyre mundësinë të zhvillojnë eksperiencë skenike dhe të përballen drejtpërdrejt me publikun. Paralelisht me koncertet dhe aktivitetet kryesore, janë organizuar edhe iniciativa plotësuese nga disa pedagogë të departamentit, përfshirë ansamble të vogla dhe grupe të përziera studentësh, si dhe zhvillimin e master-klasave dhe workshop-eve falas. Këto iniciativa u konceptuan si laboratorë praktikë, duke ofruar një platformë të vlefshme për zhvillimin profesional të studentëve dhe për fuqizimin e lidhjes së tyre me publikun.

Fakulteti i Muzikës, përmes Departamentit të Interpretimit, i jep një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucione të tjera artistike, me qëllim ofrimin e programeve të studimit të përditësuara dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Për këtë qëllim, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të rëndësishme, si Radio Televizioni Shqiptar, Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, Universiteti i Tiranës, dhe institucione të tjera të ngjashme. Këto marrëveshje janë realizuar gjithashtu në kuadër të iniciativës "Pakti për

	Universitetin" dhe kanë për qëllim plotësimin e kërkesave të studentëve, duke kontribuar në përmirësimin e funksionimit dhe realizimin e projekteve artistike dhe edukative të studentëve. Këto bashkëpunime kanë ndihmuar në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve dhe në rritjen e mundësive për integrimin e tyre në mjedisin artistik dhe kulturor. Evidenca Nr. 1.13 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i Departamentit të Interpretimit. http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=557&niveli=84 p			
Konkluzione	Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) nxit dhe promovon përfshirjen aktive të studentëve, partnerëve institucionalë, rrjeteve akademike dhe organizmave të tjerë relevantë në hartimin, zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Ky proces i përbashkët synon garantimin e cilësisë dhe realizimin me sukses të objektivave të programeve, në përputhje me nevojat formuese të studentëve dhe kërkesat e tregut të punës. Përfshirja e aktorëve të jashtëm kontribuon në rritjen e relevancës akademike dhe profesionale të ofertës studimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Forma e mësimdhënies dhe kontrolleve në programin BSC në "Perkusion" është e përcaktuar në Rregulloren e Programit të Mësimdhënies, konkretisht në nenin 11, dhe përfshin format e mëposhtme kryesore: • Mësimdhënie individuale artistike, • Leksione teorike, • Seminare, • Ushtrime (individuale dhe në grupe), • Praktika profesionale artistike, • Praktika mësimore, • Konsultime të drejtpërdrejta. Kontrolli i dijeve realizohet përmes: • Provimi i formimit artistik: • Provimi me shkrim: • Provimi me gojë: • Vlerësimi i detyrave dhe projekteve: • Provimi në grup: Mësimdhënia në Departamentin e Interpretimit është një ndërveprim aktiv midis stafit akademik dhe studentëve, i cili bazohet në krijimin e një procesi mësimor që përshtatet drejtpërdrejt dhe individualisht me nevojat e çdo studenti. Realizimi i orëve të mësimi individual, puna me grupe të vogla, zhvillimi i leksioneve dhe masterclass-ëve, janë disa nga metodat që përdoren për të arritur një transmetim efektiv të dijeve. Gjithashtu, në programin e studimeve Bachelor në "Perkusion", pedagogët zbatojnë një qasje individuale që është thelbësore në formimin artistik të studentëve, veçanërisht në mësimin e instrumentit, të kënduarit apo të kompozimit. Ky format i mësimdhënies karakterizohet nga personalizimi i plotë i procesit mësimor, ku pedagogu përshtat metodën, përmbajtjen dhe ritmin e punës në përputhje me nivelin, nevojat dhe objektivat specifike të studentit. Marrëdhënia që krijohet mes pedagogut dhe studentit është e drejtpërdrejtë, intensive dhe afatgjatë, duke i dhënë mundësi pedagogut të ndjekë nga afër zhvillimin teknik, interpretativ dhe artistik të studentit. Orët janë të fokusuara në praktikën e drejtpërdrejtë,

	korrigjimin teknik, analizën muzikore dhe përpunimin e shprehjes artistike. Një nga elementët kyç të kësaj metodologjie është feedback-u i menjëhershëm dhe i detajuar, i cili ndihmon studentin të përmirësohet në kohë reale dhe të zhvillojë një vetëdije të lartë për procesin e të mësuarit. Ky format mësimor forcon disiplinën personale dhe metodën e punës individuale, duke ndihmuar në ndërtimin e një identiteti artistik të pavarur. Përmes kësaj marrëdhënieje të veçantë, pedagogu nuk është vetëm një transmetues i dijes, por edhe një udhërrëfyes emocional, mentor artistik dhe model profesional për studentin. Kjo metodologji, e themeluar në traditën e mësimdhënies muzikore, përfaqëson një nga format më efektive dhe të pazëvendësueshme për zhvillimin profesional të muzikantëve. <i>Vizita ne institucion</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.</i> <i>Evidencë Nr. 2.0.2 Plan i mësimor i programit</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik në Universitetin e Arteve mban përgjegjësi për zhvillimin e plotë të procesit mësimor dhe realizimin e dijes në lëndët individuale dhe grupet mësimore të studentëve. Për secilën lëndë, çdo vit caktohet një titullar i lëndës i cili është përgjegjës për orientimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të procesit mësimor. Pedagogët, të cilët janë përgjegjës për lëndët, ofrojnë një mjedis interaktiv për studentët dhe mundësojnë zhvillimin e dijes duke ofruar metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies, duke u përshtatur me diversitetin dhe nevojat individuale të studentëve. Metodologjia e mësimdhënies është e fokusuar te studenti dhe përfshin: 1. Përshtatja metodologjike e pedagogut sipas specifikave dhe nevojave teknike të studentëve. 2. Analizat vetjake muzikore të studentëve mbi veprat e studiuara; 3. Puna në grup, seminarët, dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta; 4. Praktikat artistike, detyrat kursi dhe prezantimet. Për të siguruar një proces mësimor të personalizuar dhe të harmonizuar me kërkesat e tregut të punës, stafi akademik mbështetet edhe në sygjerimet e pedagogëve të ftuar që janë

	personalitete të njohura në fushat përkatëse, të cilët punojnë në institucione artistike dhe kulturore. Evidencë Nr. 2.0.2 Plani mësimor i programit
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti i Arteve, së bashku me Fakultetin e Muzikës dhe Departamentin e Interpretimit, mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënies, përmes krijimit të kushteve për studime dhe kërkime pedagogjike dhe artistike, pjesëmarrjen e personelit akademik në trajnime të vazhdueshme profesionale dhe pedagogjike, mundësimin e hapësirave për Fakultetin e Muzikës dhe Departamentin e Interpretimit, mbështetje për programet e vizitave dhe shkëmbimit të stafit akademik, si dhe krijimin e kushteve për shkëmbimin e organizuar të stafit akademik. Universiteti i Arteve, përmes Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit, mbështet në mënyrë të vazhdueshme përmirësimin e kompetencave didaktike dhe profesionale të personelit akademik, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Kjo mbështetje realizohet përmes: • Krijimit të kushteve për zhvillimin e studimeve dhe kërkimeve pedagogjike e artistike, të cilat konkretizohen gjithashtu nëpërmjet programit të studimeve të ciklit të tretë, Doktoratë në Muzikologji; • Vënies në dispozicion të hapësirave të Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit për përdorim nga personeli akademik i programit të studimeve Bachelor në "Perkusion", në funksion të organizimit dhe pjesëmarrjes në masterklasa, koncerte dhe aktivitete të tjera artistike; • Krijimit të kushteve logjistike dhe organizative, përmes ofrimit të hapësirave të përshtatshme, orareve fleksibël dhe mbështetjes nga stafi ndihmës administrativ, në kuadër të shkëmbimeve të organizuara nga institucionet partnere brenda programit Erasmus+. Gjithashtu, Universiteti i Arteve dhe Fakulteti i Muzikës mbështesin trupën pedagogjike me leje afatshkurtra për pjesëmarrje në aktivitete artistike, konferenca, simpoziume, workshop-e, masterklasa dhe projekte kërkimore, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të stafit. <i>Por në raportin vjetor, GVJ vëren se një pjesë e stafit akademik ka një pjesëmarrje të ulët në ngjarje artistike. Për këtë arsye, sygjerohet që Departamenti, në bashkëpunim me Fakultetin, të</i>

	<i>ndërmarrë masa për të stimuluar pjesëmarrjen aktive të stafit në ngjarje artistike - shkencore, duke krijuar mundësi për zhvillim profesional të stafit.</i> <i>Evidencë Nr. 3.0.9 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2022-2023</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Perkusion" zotëron kompetencat e nevojshme për të ofruar me cilësi të lartë procesin mësimor. Ky staf ka një përvojë të gjatë dhe të konsoliduar si në fushën e mësimdhënies, ashtu edhe në veprimtaritë artistike dhe interpretative, duke përbërë një vlerë të shtuar për formimin profesional të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies, me në qendër studentin, duke nxitur mendimin krijues dhe kritik, si dhe zhvillimin e autonomisë dhe përgjegjësisë individuale. Personeli siguron gjithashtu udhëheqje pedagogjike, mbështetje akademike dhe ndërtimin e marrëdhënieve të bazuara në respekt të ndërsjellë, duke krijuar një mjedis të favorshëm për të nxënë dhe për të zhvilluar kompetenca profesionale. <i>Vizita në intitucion</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Puna mësimore me studentët e programit Bachelor në 'Perkusion' përfshin përdorimin e metodave të ndryshme mësimore dhe vlerësuese, të cilat përfshijnë analiza periodike dhe pyetësorë për vitin akademik. Departamenti i Interpretimit rishikon ecurinë e procesit mësimor dhe sugjeron përmirësime të mundshme, duke ofruar një mundësi për reflektim dhe rritje të cilësisë. Në fund të vitit akademik, stafi akademik ka mundësinë të shprehë problematikat dhe të propozojë ndryshime, të cilat mund të kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. <i>Gjatë vizitës në institucion dhe në diskutimet me studentët e këtij programi, ata shprehën mendime shumë pozitive për stafin pedagogjik, metodologjinë e mësimdhënies dhe disponueshmërinë e pedagogëve. Ky feedback nga studentët pasqyron një atmosferë mbështetëse dhe angazhuese në procesin mësimor, ku pedagogët janë të gatshëm të ndihmojnë dhe të kontribuojnë në zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve.</i>

	<i>Ky feedback reflektohet gjithashtu në pyetësorët e zhvilluar nga studentët mbi procesin e mësimdhënies, ku ata kanë shprehur vlerësime pozitive për mënyrën se si zhvillohet mësimdhënia dhe mbështetja që ofrohet nga stafi pedagogjik.</i> Evidencë Nr. 3.0.6 Të dhëna nga pyetësori i studentëve Vizita në institucion
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Universiteti i Arteve është i strukturuar në fakultete dhe departamente, të cilat mbajnë përgjegjësinë për koordinimin dhe promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër, Departamenti i Interpretimit, në bashkëpunim me grupet mësimore, kontribuon në përmirësimin cilësor përmes strukturave si Sektori Mësimor, njësitë e kurrikulës dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë. Një nga elementët kyç të këtij procesi është praktika e zgjedhjes së pedagogut nga vetë studentët për mësimin individual, çka i jep prioritet personalizimit të mësimdhënies dhe forcon filozofinë udhëheqëse të institucionit në raport me cilësinë. Në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor dhe përmirësimit të mbështetjes për studentët, Universiteti i Arteve disponon Zyrën e Sektorit Mësimor dhe të Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila përbën një strukturë të rëndësishme administro-akademike. Kjo zyrë ka si qëllim të sigurojë zhvillimin e kurrikulave në përputhje me standardet institucionale dhe ligjore, të koordinojë informimin e studentëve, si dhe të mbështesë procesin mësimor në tërësi. Gjithashtu, struktura në fjalë mbulon çështje që lidhen me planifikimin mësimor, ndërtimin dhe zhvillimin e kurrikulave, orientimin dhe zhvillimin e karrierës së studentëve, si dhe mundësitë e shkëmbimeve ndërkombëtare për studentët dhe alumni-në. Ajo bashkëpunon ngushtë me Dekanët, Zëvendës Dekanët dhe Përgjegjësit e Njësive Bazë të fakulteteve për të garantuar përputhshmërinë e plotë të procesit mësimor me kërkesat akademike dhe ligjore. Evidencë Nr. 5.23 Rregullore e funksionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.
Konkluzione	Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) garanton një proces mësimor të orientuar drejt studentit, duke zbatuar metoda dhe praktika bashkëkohore që synojnë arritjen e rezultateve të të nxëniet dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore. Procesi i të nxëniet bazohet në ndërveprim të vazhdueshëm pedagogjik, në përdorimin e metodologjive aktive, si dhe në mbështetjen e zhvillimit të kompetencave individuale dhe

	<i>kolektive të studentëve, në përputhje me standardet më të mira të arsimit të lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" në Universitetin e Arteve përdor një sistem vlerësimi nga 1 deri në 10, ku notat nga 5 e lart janë kaluese. Vlerësimi përfshin komponentë të ndryshëm si provimet artistike, teorike, detyrat, projektet dhe frekuentimi. Secili komponent ka një peshë të caktuar në përfundimtar dhe është i përcaktuar në planin mësimor dhe programin e lëndës. Provimet mund të jenë me shkrim, me gojë, ose të bazuara në realizimin artistik. Të gjitha këto metoda vlerësimi janë të strukturuar dhe bëhen të ditura për studentët që në fillim të semestrit. Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" përfshin një strukturë të detajuar të vlerësimit të studentëve, ku çdo komponent ka një peshë të caktuar në notën përfundimtare. Puna mësimore kalon nëpër disa faza të ndryshme të mësimit dhe kontrollit, duke përfshirë bashkëbisedime, kontrole teknike, mbrojtje të detyrave, projekte, provime të kursit, dhe aktivitete artistike. Secili element (si pjesa artistike, teorike, ushtrimore, detyrat, etj.) ka një peshë të caktuar që lidhet me kreditet e lëndës dhe aktivitetet formuese të saj. Mënyra e organizimit të provimeve dhe pesha e secilit komponent janë të përcaktuara në programin e lëndës dhe bëhen të ditura për studentët në fillim të semestrit. Për lëndën "Folklor": ☐ Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjërata: 10% ☐ Puna individuale: 10% ☐ Ushtrimet: 10% ☐ Kolokiumi I: 10% ☐ Kolokiumi II: 10% ☐ Provimi përfundimtar: 50% Për vlerësimin e diplomës: • Punë individuale përgatitore e koncertit të diplomës: 20% • Koncerti i diplomës: 80%

	Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion. Evidencë Nr. 2.0.2 Plan i mësimor i programit
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në kreun III të Rregullores së Programit Bachelor "Perkusion", kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet nëpërmjet metodave dhe formave të ndryshme. Këto metoda janë të dizajnuara për të mundësuar që studentët të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat që kanë fituar. Kriteri i testimit përfshin forma të tilla si: 1. Provimi i formimit artistik (për lëndët e formimit special) – ky provim vlerëson realizimin artistik dhe teknik të programit. 2. Provimet me shkrim për lëndët teorike. 3. Provimi me gojë. 4. Vlerësimi i detyrave dhe projekteve muzikore. 5. Provimi në grup. Gjithashtu, njësia bazë/personeli akademik ka përgjegjësinë që të vlerësojë dhe të përmirësojë periodikisht metodat dhe format e mësimdhënies, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre. Testimi i njohurive mund të bëhet nëpërmjet formave të tilla si: • Bashkëbisedime, • Kontrolle teknike, • Mbrojtje të detyrave dhe projekteve individuale/grup, • Mbrojtje të praktikave profesionale artistike, • Provime të ndërmjetme, • Provime përfundimtare, • Mbrojtje të temave të diplomave, dhe • Aktivitetet artistike. Në të gjitha këto forma, mënyra e organizimit të provimit dhe pesha e secilit komponent pasqyrohen në syllabusin përkatës të lëndës. Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion. Evidencë Nr. 2.0.2 Plan i mësimor i programit
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë	Metodologjia e mësimdhënies për programin Bachelor "Perkusion" është shumë e përshtatshme për një disiplinë që kërkon një zhvillim të thellë dhe të balancuar të aftësive teknike dhe artistike. Ajo kombinon teori dhe praktikë, duke u fokusuar në aspekte të ndryshme të mësimdhënies që nxisin kreativitetin dhe bashkëpunimin.




studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	<i>Bazuar në diskutimet me studentët dhe stafin pedagogjik, qasja fleksibël dhe e orientuar nga studentët e bën këtë metodologji të përshtatshme për të nxitur zhvillimin e aftësive të shumëanshme që kërkon një instrumentist perkusioni.</i> Vizita në institucion			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Universiteti i Arteve përdor metoda të shumëllojshme dhe fleksibël pedagogjike, të përshtatshme për rezultatet e pritshme të nxënësve. Përfshirja e projekteve artistike dhe detyrave individuale mundëson që studentët ti aplikojnë në kushte reale performante. Vlerësimi, i cili përfshin jo vetëm provat teknike, por edhe diskutimet dhe reflektimet mbi zhvillimin e aftësive kreative, ndihmon në përcaktimin e nivelit të përparimit dhe në orientimin e mëtejshëm të studentëve. Aktivitetet e tilla si workshopet dhe masterklasat u mundësojnë studentëve të përvetësojnë aspekte profesionale dhe teknike. Kjo metodologji është dinamike dhe e përshtatshme për të zhvilluar aftësitë komplekse që kërkon një profesion i tillë artistik dhe teknik. Vizita në institucion			
Konkluzione	<i>Institucioni harton dhe miraton rregullore dhe procedura të qarta dhe të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijes dhe aftësive profesionale të studentëve. Gjithashtu, garanton zbatimin rigoroz dhe të qëndrueshëm të këtyre rregulloreve dhe procedurave, me qëllim sigurimin e një procesi vlerësimi të drejtë, transparent dhe në përputhje me standardet e arsimit të lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, kompetencave dhe aftësive profesionale në kuadër të Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës realizohet në përputhje me përmbajtjen


profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	dhe kërkesat e syllabus-it përkatës të lëndëve dhe moduleve që përfshihen në programin e studimit Bachelor në "Perkusion". Procesi i vlerësimit zhvillohet përgjatë gjithë vitit akademik, në përputhje me natyrën specifike të fushës muzikore, dhe realizohet nga titullari i lëndës dhe/ose modulit përkatës. Vlerësimi përfundimtar i studentit pasqyron një analizë të plotë të performancës gjatë gjithë vitit akademik dhe përfshin komponentë të ndryshëm, të tillë si interpretimi artistik, përvetësimi i njohurive teorike, ushtrimet praktike, detyrat individuale, projektet artistike, testimet e ndërmjetme dhe pjesëmarrja aktive në procesin mësimor. Pësia specifike që i jepet secilit prej këtyre elementëve në vlerësimin përfundimtar lidhet ngushtësisht me vlerën në kredite të lëndës dhe me natyrën e veprimtarive formuese që ajo përmban, ashtu siç përcaktohet në planin mësimor dhe dokumentacionin pedagogjik përkatës. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti i Arteve zbaton një sistem të strukturuar dhe transparent të administrimit të provimeve për të gjitha programet e studimit, me qëllim garantimin e integritetit akademik dhe shmangien e çdo forme abuzimi gjatë procesit të vlerësimit. Në këtë kuadër, provimet për lëndët profesionale artistike zhvillohen me prani publike, duke reflektuar karakterin interpretativ dhe performativ të këtyre disiplinave, ndërsa provimet për lëndët teorike administrohen përmes tezave të strukturuar, të cilat vlerësohen nga komisione të specializuara në përputhje me rregulloret përkatëse akademike. Rezultatet e provimeve bëhen publike brenda një afati maksimal prej pesë ditësh pas përfundimit të provimit dhe regjistrohen në sistemin elektronik PITAGORA, duke siguruar akses të drejtpërdrejtë dhe të sigurt për studentët. Në funksion të të drejtave akademike, studentëve u garantohet mundësia për të kërkuar verifikimin e vlerësimit të dhënë dhe, në rast mospajtimi, ata kanë të drejtë të paraqesin ankesë formale, e cila shqyrtohet në përputhje me procedurat e përcaktuara nga institucionet përkatëse brenda universitetit. Ky sistem synon të forcojë besueshmërinë dhe objektivitetin e procesit të vlerësimit në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë. http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=585&niveli=81 http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=963&niveli=82




	<i>Evidencë Nr. 4.35 Fotot nga sistemi PITAGORA.</i> <i>Evidencë Nr. 4.36 Fotot nga sistemi PITAGORA-vlerësim pedagogu, pasqyrim tek studenti. Evidencë Nr. 4.37 Manuali PITAGORA.</i> <i>Evidencë Nr. 5.12 Faqja e web-it të UART, sistemi PITAGORA.</i> <i>Evidencë Nr. 6.0.1 Manuali i përdorimit të sistemit të Microsoft Teams</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Rregullorja e Studimeve për Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor në "Perkusion" e Universitetit të Arteve ka përcaktuar në mënyrë të detajuar dhe transparente sistemin e vlerësimit, format e kontrollit të njohurive, sezonet e provimeve dhe kriteret për kalimin në vitin akademik pasardhës. Forma e vlerësimit për secilën lëndë përcaktohet në planin mësimor dhe i komunikohet studentëve në fillim të çdo semestri, duke garantuar një kuadër të qartë dhe të parashikueshëm për ecurinë e tyre akademike. Provimet për lëndët teorike realizohen me shkrim, duke respektuar standardet e sigurisë dhe konfidencialitetit të procesit, ndërsa rezultatet e tyre përpunohen dhe konvertohen në nota numerike sipas sistemit të vlerësimit në fuqi. Hartimi i tezave për këto lëndë bëhet nga titullarët përkatës dhe më pas ato miratohen nga përgjegjësit akademikë të njësisë, duke siguruar cilësi dhe përputhje me objektivat e kurrikulës. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit akademik në programin Bachelor në "Perkusion" është një proces gjithëpërfshirës që mbulon të gjitha komponentët e përcaktuara në programin mësimor. Ky sistem është i strukturuar për të siguruar zhvillimin e plotë të studentëve, si në aspektin teorik ashtu edhe praktik, duke u fokusuar në disa faza kryesore: vlerësimi i ndërmjetëm, provimet përfundimtare të fundvitit, praktika profesionale dhe mbrojtja e diplomës. Në këtë kuadër, procesi i vlerësimit fokusohet në përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive teknike dhe artistike të studentëve. Pas çdo ore mësimi, studentët marrin udhëzime të drejtpërdrejta nga pedagogët, të cilët ofrojnë këshilla për avancimin teknik dhe artistik. Ky feedback i menjëhershëm është një pjesë kyçe e metodologjisë mësimore dhe kontribuon në zhvillimin e

	vazhdueshëm të studentëve, duke ndihmuar ata të përmirësojnë aftësitë e tyre në kohë reale. Në përfundim të çdo semestri, stafi akademik realizon një vlerësim të detajuar të ecurisë së studentëve, duke identifikuar pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim. Kjo analizë e përditësuar i mundëson pedagogëve të përcaktojnë objektiva të qarta për semestrin pasardhës, duke siguruar një mundësi për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së studentëve. Për më tepër, në fund të vitit kalendarik, Departamenti i Interpretimit realizon një analizë të gjithë procesit mësimor dhe veprimtarive artistike të zhvilluara gjatë vitit. Ky vlerësim përmbledh të dhënat nga proceset e mësimit dhe aktiviteteve artistike, duke kontribuar në vlerësimin institucional të cilësisë së arsimit. Ky mekanizëm analitik siguron një cikël të vazhdueshëm feedback-u dhe përmirësimi, që synon përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale dhe ndihmon Fakultetin e Muzikës të forcojë rolin e tij në zhvillimin e artistëve të rinj. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i> <i>Evidencë Nr. 3.0.8 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Interpretimit Kreu V neni 29</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Fakultetin e Muzikës, procesi i provimeve zhvillohet në prani të studentëve dhe komisionit përkatës të provimit, duke respektuar standardet akademike të transparencës dhe integritetit. Gjatë zhvillimit të provimeve, studentëve u ndalohet rreptësisht përdorimi i pajisjeve elektronike, në funksion të garantimit të një ambienti të drejtë dhe të paanshëm vlerësimi. Për lëndët speciale, të cilat kërkojnë kushte të veçanta teknike ose artistike, provimet mund të organizohen edhe në ambiente të hapura, të përshtatura sipas natyrës së veprimtarisë interpretative. Shkeljet e etikës akademike, si kopjimi dhe plagjiatura, trajtohen si shkelje të rënda disiplinore dhe sjellin pasoja serioze, përfshirë vlerësimin negativ dhe përjashtimin nga provimi ose programi i studimit. Vlerësimi i studentëve bazohet ekskluzivisht në meritë dhe performancë të dëshmuar, duke garantuar objektivitet dhe drejtësi në proces. Në përputhje me parimet e transparencës dhe drejtësisë, studentët kanë të drejtën ligjore dhe institucionale të kërkojnë rishikimin e vlerësimit nëse kanë dyshime mbi korrektësinë e tij. Ankesat shqyrtohen nga komisioni përkatës, i cili administron platformën anti-plagjiaturë, e mbështetur nga

	Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit. Ky proces garanton që çdo ankesë të trajtohet në mënyrë të paanshme dhe profesionale, duke siguruar që çdo vendim të merret në përputhje me procedurat e parashikuara dhe duke ruajtur integritetin e sistemit të vlerësimit akademik. <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimet në Universitetin e Arteve realizohen nga komisioni i provimit përkatës, i cili përbëhet nga pedagogu dhe stafi akademik i lëndës. Rezultatet e provimit shpallen brenda 5 ditëve nga mbajtja e tij dhe ato bazohen në meritë, duke siguruar një proces vlerësimi të drejtë dhe transparent. Për menaxhimin e studimeve dhe shpërndarjen e rezultateve në kohë reale, përdoret sistemi PITAGORA, i cili mundëson akses të shpejtë dhe efikas për studentët. Në rast se ndonjë student ka dyshime mbi vlerësimin e tij, ai ka të drejtë të ankimojë rezultatin brenda 5 ditëve pas zhvillimit të provimit, duke iu mundësuar një shqyrtim të rishikuar dhe të drejtë të situatës. <i>Evidencë Nr. 5.12 Faqja e web-it të UART, sistemi PITAGORA.</i> <i>Evidencë Nr. 4.35 Fotot nga sistemi PITAGORA.</i> <i>Evidencë Nr. 4.36 Fotot nga sistemi PITAGORA-vlerësim pedagogu, pasqyrim tek studenti.</i> <i>Evidencë Nr. 4.37 Manuali PITAGORA.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, përmes rregulloreve përkatëse dhe strukturave specifike, garanton mundësinë e rishikimit të notave për studentët e programit BSc në "Perkusion", në përputhje me procedurat e vlerësimit dhe statutin e universitetit. Sipas rregullores, studentët kanë të drejtën të përmirësojnë notën deri në tre herë gjatë tre viteve të ciklit të parë, përveç lëndëve speciale. Studentët e vitit të parë dhe të dytë mund të riprovojnë vetëm një herë gjatë sezonit të vjeshtës, ndërsa studentët e vitit të tretë mund të riprovojnë vetëm në sezonin e verës, dy javë para mbrojtjes së diplomës. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i>




Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Kërkesa për përmirësim duhet të bëhet brenda një jave pas provimit, dhe nota përfundimtare do të mbetet e tillë nëse studenti nuk paraqitet në provim pas kërkesës për përmirësim. Në rastin e moduleve të përbashkëta, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë modulin. <i>Gjatë bisedave me studentët dhe stafin akademik, është vënë re se rastet e ankimeve nga studentët kanë qenë shumë të rralla, për shkak të metodologjisë së vazhdueshme të studimit dhe konsultave të shpeshta me pedagogun, të cilat i mundësojnë studentëve të jenë të informuar mbi ecurinë e tyre artistike gjatë gjithë semestrit.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i> <i>Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni garanton një proces vlerësimi të drejtë dhe transparent, i cili bazohet në meritën e çdo studenti dhe siguron trajtim të barabartë për të gjithë. Përfshihet edhe një proces i rregulluar dhe i qartë ankimimi, që u jep studentëve mundësinë për të paraqitur shqetësimet dhe për të kërkuar rishqyrtim të rezultateve në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, synon zhvillimin e aftësive të studentëve në mjeshtërinë e ekzekutimit dhe interpretimit të veprave muzikore në stile të ndryshme, duke i përgatitur ata për karriera artistike dhe për integrim në tregun e punës. Ky program fokusohet në zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike, të cilat janë të nevojshme për të arritur nivele të larta të performancës muzikore dhe për të kontribuar në dinamikën e skenës muzikore. Për shkak të natyrës specifike të mësimdhënies në këtë fushë, studentët kanë mundësinë të

	këshillohen pas çdo ore mësimi për të përmirësuar performancën e tyre dhe për të ndihmuar në forcimin e aftësive të tyre artistike.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi Bachelor në "Perkusion" fokusohet në zhvillimin e aftësive për interpretim muzikor, duke ofruar një qasje të gjithanshme që integron jo vetëm aspektet artistike të muzikës, por edhe disa lëndë që balancojnë formimin muzikor me zhvillimin e aftësive në fusha jo-artistike, si Informatika dhe Menaxhimi i Projekteve. Ky kombinim i formimit artistik dhe atij praktik është krijuar për të ofruar një përgatitje të plotë për studentët, duke i mundësuar ata të zhvillojnë aftësi të nevojshme për t'u adaptuar në një treg pune të ndryshueshëm dhe të kërkuar, si në fushën artistike ashtu edhe në menaxhimin e aktiviteteve muzikore dhe menaxhimin e projekteve të lidhura me artin dhe muzikën. <i>Evidencë Nr. 2.0.8 Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve sipas planit mësimor</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në Universitetin e Arteve, kompetencat dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes një procesi të vazhdueshëm vlerësimi që përfshin provimet përfundimtare, mbrojtjen e diplomës dhe monitorimin e progresit gjatë vitit akademik. Për shkak të natyrës specifike të organizimit të mësimi, studentët marrin këshilla të rregullta pas çdo ore mësimi për të përmirësuar performancën e tyre. Ky proces i përditshëm vlerësimi dhe mbështetje i siguron studentëve mundësi të vazhdueshme për të përmirësuar aftësitë e tyre artistike dhe profesionale, duke i ndihmuar ata të arrijnë standardet e kërkuara për një karrierë të suksesshme në fushën e muzikës.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të	Programi Bachelor "Perkusion" në Universitetin e Arteve zhvillon aftësi artistike dhe teknike tek studentët, duke u fokusuar në pavarësinë, ekzekutimin e pjesëve të ndryshme muzikore dhe krijimtarinë. Kjo realizohet përmes praktikës profesionale dhe artistike, ku studentët aplikojnë njohuritë në kontekste reale, si në institucion, ashtu edhe jashtë tij. Pjesëmarrja në grupe dhe ekzekutimi në koncerte ose evente artistike është një aspekt thelbësor i programit, pasi ndihmon në zhvillimin e aftësive kolektive dhe i ofron mundësinë studentëve të matin performancën e tyre përballë publikut, veçanërisht në fusha si muzika jazz. Sipas raportit vjetor 2022–2023 të Departamentit të Interpretimit, departamenti mbështet vazhdimisht projektet artistike individuale dhe kolektive të pedagogëve dhe

përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	studentëve përmes organizimit të masterklasave, eventeve artistike dhe mundësive për shfrytëzimin e sallave si për stafin akademik ashtu edhe për studentët. Megjithatë, një sfidë e vazhdueshme për programin është mungesa e mobilitetit të stafit dhe studentëve. Edhe pse programi është ende në fazën e parë të akreditimit, dhe institucioni po bën përpjekje për mundësimin e mobilitetit, deri tani nuk është zhvilluar asnjë mobilitet për stafin ose studentët gjatë tre viteve të fundit. Ky aspekt mbetet një çështje që kërkon përmirësim për të ofruar mundësi më të mëdha zhvillimi dhe shkëmbimi ndërkombëtar. <i>Evidencë Nr. 2.14 Koncerte, festivale, aktivitete.</i> <i>Evidencë Nr. 2.15 Të dhëna mbi aktivizimin e studentëve që po frekuentojnë programin e studimit "Perkusion".</i> <i>Evidencë Nr. 2.16 Projektet Artistike të Programit të studimit.</i> <i>Evidencë Nr. 2.18 Aktivitetet artistike, koncertet e studentëve dhe stafit akademik</i> <i>Evidencë Nr. 3.0.2 Postera dhe foto të koncerteve dhe masterklaseve</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli Akademik i Fakultetit të Muzikës organizon vazhdimisht një gamë të gjerë aktivitetesh artistike si koncerte, recitale dhe muzikopremiera, të cilat mund të jenë solo ose me ansamble. Këto aktivitete artistike jashtë programit të studimit janë një mundësi për studentët dhe profesionistët për të shfaqur zhvillimet dhe arritjet e tyre artistike. <i>Në lidhje me veprimtarinë shkencore, veçanërisht përsa i përket organizimit të orëve të hapura dhe leksioneve që trajtojnë aspekte teorike dhe shkencore, rezulton se stafi pedagogjik i programit BSC "Perkusion" nuk ka mbajtur leksione të hapura në këtë aspekt deri më tani. Ky fakt mund të lidhet me mungesën e një strukture të qartë për realizimin e këtyre aktiviteteve ose mund të pasqyrojë prioritetet e tjera të stafit, të cilat kanë pasur fokus më shumë në zhvillimin praktik dhe artistik të studentëve. Pavarësisht kësaj, organizimi i leksioneve të hapura, që përfshijnë diskutime dhe analizë të aspekteve teorike dhe shkencore të muzikës, mund të paraqesë një mundësi të vlefshme për rritjen e transparencës akademike dhe për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve kërkimore të fakultetit.</i> <i>GVJ rekomandon që të merren masa konkrete në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura, në veçanti për lëndët teorike të këtij programi. Zbatimi i kësaj mase do të kontribuonte në rritjen e nivelit shkencor dhe zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë kërkimore brenda departamentit.</i>

	<i>Evidencë Nr. 2.14 Koncerte, festivale, aktivitete.</i> <i>Evidencë Nr. 2.15 Të dhëna mbi aktivizimin e studentëve që po frekuentojnë programin e studimit "Perkusion".</i> <i>Evidencë Nr. 2.16 Projektet Artistike të Programit të studimit.</i> <i>Evidencë Nr. 2.18 Aktivitetet artistike, koncertet e studentëve dhe stafit akademik</i> <i>Evidencë Nr. 3.0.2 Postera dhe foto të koncerteve dhe masterklaseve</i>			
Konkluzione	Në lidhje me veprimtarinë shkencore, veçanërisht përsa i përket organizimit të orëve të hapura dhe leksioneve që trajtojnë aspekte teorike dhe shkencore, rezulton se stafi pedagogjik i programit BSC "Perkusion" nuk ka mbajtur leksione të hapura në këtë aspekt deri më tani. Ky fakt mund të lidhet me mungesën e një strukture të qartë për realizimin e këtyre aktiviteteve ose mund të pasqyrojë prioritetet e tjera të stafit, të cilat kanë pasur fokus më shumë në zhvillimin praktik dhe artistik të studentëve. Pavarësisht kësaj, organizimi i leksioneve të hapura, që përfshijnë diskutime dhe analizë të aspekteve teorike dhe shkencore të muzikës, mund të paraqesë një mundësi të vlefshme për rritjen e transparencës akademike dhe për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve kërkimore të fakultetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Programi i studimit Bachelor në "Perkusion" përcakton kërkesat për diplomimin e studentëve, të cilat përfshijnë përfundimin e të gjitha detyrimeve akademike dhe financiare. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha kreditet e lëndëve dhe detyrimet financiare para mbrojtjes së diplomës. Provimi i diplomës është një koncert i cili shërben si mbrojtje artistike, ku studentët përgatisin dhe ekzekutojnë aranzhime muzikore, zakonisht me ansambël. Ky koncert është një mundësi për studentët të demonstrojnë aftësitë e tyre teknike dhe artistike, si dhe për të treguar përparimin e bërë gjatë studimeve.

	Të gjitha procedurat për mbrojtjen e diplomës janë të organizuara dhe mbikëqyra nga pedagogu udhëheqës, i cili asiston studentët gjatë fazës përgatitore dhe gjatë provës. <i>Evidencë Nr. 3.16 Model i vlerësimit të komisionit të diplomës</i> <i>Evidencë Nr. 5.13 Syllabusi i punimit të diplomës</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Universiteti i Arteve ofron mbështetje për studentët në realizimin e detyrimeve përmbyllëse, duke ofruar informacion dhe materiale të nevojshme për programin BSC. në "Perkusion". Sekretaria mësimore informon studentët për datat e detyrimeve përmbyllëse dhe regjistrimin elektronik. Personeli akademik asiston vazhdimisht për aspektet teknike dhe organizative të Koncertit të Diplomës. Studentët janë në vitin e tretë dhe do të përfundojnë detyrimet përmbyllëse në fund të vitit akademik 2024-2025. <i>Evidencë Nr. 5.23 Rregullore e funksionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Koncerti i Diplomës në Fakultetin e Muzikës është një prezantim individual ku studenti demonstroi aftësitë e tij profesionale në perkusion, përmes një programi me pesë pjesë të avancuara. Procesi përfshin dorëzimin paraprak të materialeve, zhvillimin e provave dhe përzgjedhjen e ansamblit Combo me miratimin e pedagogut udhëheqës, i cili monitoron të gjithë aktivitetin. <i>Evidencë Nr. 5.13 Syllabusi i punimit të diplomës</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i	Studenti dhe pedagogu përcaktojnë afate për programin e diplomës, ku studenti udhëhiqet metodologjikisht dhe konsultohet rregullisht për ecurinë e punës. Programi i diplomës miratohet nga pedagogu dhe studenti ndjek një grafik konsultimesh të detyrueshëm. Modalitetet e diplomimit në programin e studimit Bachelor në "Perkusion" përfshijnë një mbrojtje artistike përmes një koncerti bazuar në syllabusin përkatës. Studentët mund të mbrojnë temën e diplomës vetëm pasi të kenë përmbyllur të gjitha detyrimet akademike dhe të kenë fituar kreditet e nevojshme sipas programit të studimit. Para mbrojtjes së diplomës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe materiale ndaj universitetit. Fakulteti i Muzikës, brenda dy muajsh nga fillimi i vitit shkollor, i njofton studentët e vitit të fundit për temat dhe programet e diplomës. Ky proces siguron që çdo student të

plotë për t'u paraqitur para komisionit.	përmbushë standardet akademike dhe financiare për të përfunduar me sukses programin e studimit. <i>Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, me VSA</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Perkusion</i> <i>Evidencë Nr. 5.13 Syllabusi i punimit të diplomës</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti i Arteve, si institucion artistiko-kërkimor, vendos në dispozicion ambiente si klasa artistike, biblioteka, fonoteka dhe salla koncertesh, si dhe pajisje audio-video për veprimtari mësimore dhe artistike. Gjithashtu, institucioni, do të organizojë së shpejti konferencën “Konferenca e Parë Ndërkombëtare mbi Artet dhe Edukimin”. Në këtë aspekt, rektorati ka zhvilluar takim me studentët e ciklit të tretë të studimeve, doktoratë, si dhe me stafin akademik dhe drejtuesit e programeve doktorale, ku në qendër të këtij takimi ishte Konferenca e Parë, e cila do të zhvillohet në ambientet e Universitetit të Arteve në qershor 2025. Përmes takimit, institucioni inkurajoi studentët dhe pedagogët që të marrin pjesë aktivisht në këtë konferencë me punimet e tyre shkencore, duke kontribuar në zhvillimin e debatit akademik dhe shkëmbimin ndërkombëtar të përvojave në fushën e arteve dhe edukimit. Nëpërmjet kësaj konferencë artistike-shkencore, institucioni asiston studentët për matjen e dijeve dhe përballjen e tyre me dijen shkencore dhe publikun akademik. http://uart.edu.al/index.php?id=1354 http://uart.edu.al/index.php?id=1347
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Fakulteti i Muzikës organizon tre sezona për mbrojtjen e diplomës: në verë, në vjeshtë dhe në dimër. Pas përfundimit të provimit, kryetari i komisionit mbledh anëtarët për të vlerësuar punimin, ku secili anëtar jep pikët përkatëse dhe e nënshkruan vlerësimin. Të gjitha vlerësimet dokumentohen dhe i bashkëngjiten procesverbalit ku regjistrohet nota përfundimtare. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative ose nuk paraqitet në sezonin e parë, ai ka të drejtë të ripërsërisë procesin brenda afateve të përcaktuara nga rregullorja e studimeve. <i>Evidencë Nr. 5.13 Syllabusi i punimit të diplomës</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të	Në përfundim të studimeve, studentët që plotësojnë kriteret dhe mbrojnë me sukses diplomën pajisen me diplomë dhe suplementin përkatës, të miratuar nga Senati Akademik dhe të regjistruar nga QSHA me numër unik identifikimi. Për

miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	programet në muzikë, lëshimi mund të ndodhë deri në gjashtë muaj pas mbrojtjes. Universiteti ruan kopje të dokumentacionit dhe ofron informacion sipas kërkesës, përfshirë listën e notave dhe shkallën e përmbytjes së standardeve akademike. <i>Evidencë Nr. 5.13 Syllabusi i punimit të diplomës</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në Universitetin e Arteve, dokumentimi i aktivitetit akademik i studentëve realizohet në formate fizike dhe elektronike, nën administrimin e njësive përkatëse përgjegjëse gjatë gjithë ciklit të studimeve. Programet mësimore, përfshirë formatin, planet e studimit dhe kreditë, hartohen dhe menaxhohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe strukturat e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloret e institucionit. Arkiv-Protokolli i universitetit ka përgjegjësinë për ruajtjen e dokumentacionit dhe korrespondencës zyrtare, ndërsa çdo fakultet disponon arkivën e vet të pavarur. Sekretaria Mësimore, si njësi përgjegjëse për katalogimin dhe arkivimin e të dhënave në nivel fakulteti, siguron ruajtjen e materialeve edhe në një server qendror të mbrojtur ndaj katastrofave. Në përputhje me rregulloren për përdorimin e teknologjisë së informacionit, çdo njësi përkatëse arkivon gjithashtu dokumentacionin elektronik në formate CD dhe DVD, duke garantuar ruajtjen dhe aksesin e sigurt të informacionit akademik. <i>Evidencë Nr. 3.17 Udhëzimi nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.</i> <i>Evidencë Nr. 3.19 Kopje e regjistrit themeltar.</i> <i>Evidencë Nr. 3.20 Kopje e regjistrit të arritjeve</i> <i>Evidencë Nr. 3.21 Kopje e regjistrit të diplomave</i> <i>Evidencë Nr. 3.22 Rregullorja e funksionimit të sekretarive mësimore të fakulteteve në Universitetin e Arteve.</i> <i>Evidencë Nr. 5.23 Rregullore e funksionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni</i> <u>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=134&niveli=91</u>
Konkluzione	Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ndjek një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për përmbytjen e detyrimeve përmbyllëse të studentëve në programet e studimit. Pas përfundimit të suksesshëm të programit, studentët pajisen me dokumentacionin përkatës, i cili vërteton arritjen e kualifikimeve dhe plotësimin e të gjitha kërkesave akademike.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në takimet e zhvilluara dhe dokumentacionin e pasqyruar në raportin e vetëvlerësimit (RVB), GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Perkusion” përfaqëson një risi në zhvillimin e mëtejshëm të ofertës akademike të Fakultetit të Muzikës, pranë Departamentit të Interpretimit të Universitetit të Arteve. Programi është projektuar dhe zhvillohet nga një staf akademik me kualifikime të larta (tituj “Profesor”, “Dr.”, “MSc”), me eksperiencë të gjerë artistike dhe krijimtari të pasur profesionale, si dhe me kontribute të njohura në artin dhe kulturën shqiptare. Procesi mësimor për lëndët individuale/speciale realizohet në mënyrë të personalizuar me çdo student, duke garantuar cilësi të lartë dhe përshtatje me specifikat e programit. Programi disponon gjithashtu hapësirat dhe mbështetjen logjistike të nevojshme për zhvillimin normal të tij. Sa i përket strukturës së stafit, të dhënat për tre vitet akademike janë si më poshtë: Viti akademik 2022–2023: 17 PAE (1 Prof., 3 Prof. Asoc. Dr., 5 Prof. Asoc., 2 Dr., 1 Doc., 5 MSc) dhe 7 PAK (1 Akademik, 1 Prof. Dr., 1 Prof., 1 Dr., 3 MSc). Viti akademik 2023–2024: Nuk është hapur program i studimit Perkusion në këtë vit akademik. Viti akademik 2024–2025: 19 PAE (2 Prof. Asoc. Dr., 4 Prof. Asoc., 1 Prof., 2 Dr., 1 Doc., 9 MSc) dhe 8 PAK (1 Akademik, 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr., 4 MSc). Kjo strukturë tregon një përpjekje të qëndrueshme për të ruajtur një raport të mirë mes PAE dhe PAK, duke garantuar cilësi dhe

	mbulim të plotë të nevojave të programit. Megjithëse raporti PAE/PAK është brenda kuadrit ligjor. Të dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie tregojnë se për vitin akademik 2023–2024 nuk ka pasur regjistrime; për rrjedhojë, nuk rezultojnë të dhëna për programin në atë vit në tabelën 6.2. Në rast se përsëritet skenari i vitit akademik 2023–2024, kjo për shkak edhe të specifikave të vetë programit dhe të numrit të pranimeve të studentëve, duhen parë mekanizma të cilat garantojnë mbarëvajtjen e programit dhe të trupës pedagogjike. Raporti midis stafit PAE dhe PAK është në përputhje me raportin 70% PAE dhe 30% PAK, siç parashikohet në VKM nr. 41. 2024- 2025 / 19 PAE – 8 PAK, PAE 70.3 % - PAK 29.6% 2023-2024 / 0 PAE – 0 PAK (nuk ka pasur regjistrime) 2022 – 2023 / 17 PAE – 7 PAK, PAE 70.8% - PAK 29.1% <i>Evidencë Nr. 4.0.I – Lista e stafit akademik sipas titujve përkatës, referuar Tabelës 7të RVB-së</i> Tabelat 6.1; 6.2; 6.3																									
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Gjithashtu nga tabela 4 rezulton që ngarkesa mësimore për PAE në disa raste shkon deri 510 orë mësimore, çfarë favorizon trajtim të diferencuar të personelit të angazhuar me këtë program studimi. Në lidhje me planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës me ngarkesën mësimore (orë), të dhënat vijnë si: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>1723</td><td>1224</td><td>499</td><td>71.0% / 28.9%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>1573</td><td>953</td><td>620</td><td>60.5% / 39.4%</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table> Në lidhje me orët totale dhe ngarkesën në auditor të stafit PAE/PAK, shihet një ndarje e mirë pavarësisht se janë marrë masa për vitin e fundit akademik, sygjerohet që të konsolidohen masat në vijim për programin e studimit, për të siguruar një balancë më të mirë mes ngarkesës dhe cilësisë së mësimdhënies. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e procesit mësimor dhe në optimizimin e angazhimit të stafit akademik për vitet e ardhshme. Në lidhje me realizimin e orëve suplementare në auditor ose mbikqyrjen e praktikave profesionale Për realizimin e tyre kanë dakortësi me drejtuesin e departamentit. Në vitin akademike 2023 - 2024 programi i	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	1723	1224	499	71.0% / 28.9%	2023-2024	-	-	-	-	2024-2025	1573	953	620	60.5% / 39.4%					
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																						
2022-2023	1723	1224	499	71.0% / 28.9%																						
2023-2024	-	-	-	-																						
2024-2025	1573	953	620	60.5% / 39.4%																						

	studimit nuk ka qënë aktiv dhe për këtë arsye nuk ka ngarkesë mësimore. Referenca RVB / Tabela 12.1; 12.2; 12.3
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar, RVB dhe gjithashtu vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Bachelor në “Perkusion”. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Perkusion” ka nënshkruar kontratat me UA sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, dhe stafi akademik me kontratë, për vetë specifikën të këtij programi, përtej zbatimit të kontratave për staf akademik me kohë të pjessëshme i kushtohet vëmendje për të pasur një bashkëpunim sa më të gjatë. Duke qënë se është një entitet shtetëror UART është i detyruar të paguaj dhe deklarojë kërkesat ligjore Evidence Nr. 4.0.2 – Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018 Evidence Nr. 4.0.3 – Ngarkesa mësimore e stafit akademik Evidence Nr. 4.0.4 – Rregullorja e UART, neni 96
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Pas takimit në institucion, GVJ u njoh me procedurat e ndjekura për punësimin e stafit akademik në Universitetin e Arteve, të cilat zhvillohen nëpërmjet konkursit të hapur dhe transparent, siç përcaktohet në nenin 92 të Rregullores së brendshme. Nevojat për staf lindin në nivel departamenti dhe kriteret shtesë miratohen nga Rektori. Për programin “Perkusion”, vlerësohet edhe veprimtaria artistike e kandidatëve. Rektori miraton listën vjetore të stafit me kohë të përkohshme, bazuar në propozimet e departamenteve dhe planet mësimore. Në bazë të VKM nr. 145, UART ka të drejtë të ftojë artistë dhe studiues vendas apo të huaj për angazhime afatshkurtra akademike dhe kërkimore. Referanca: RVB Takimi ne Institucion Evidenca Nr. 4.0.4 – Rregullorja e UA, neni 92, neni 93, neni 94 Evidenca Nr. 4.0.8 – Njoftime për punësim në UART http://uart.edu.al/index.php?id=604&niveli=132 Evidenca Nr. 4.0.9 – Miratimi i kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për personel akademik me kontratë me kohë të caktuar dhe me angazhim të pjesshëm në UART për vitin akademik 2021–2022




Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Pas takimit në institucion, GVJ u njoh me përfshirjen e personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Fakultetin e Muzikës, i cili kontribuon në zhvillimin e procesit mësimor dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ambienteve, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017. Struktura përfshin sekretarinë, punonjës shërbimi dhe specialistë teknikë, kjo për arsye sipas specifikës së programit të studimit. <i>Evidencë Nr. 1.0.2 – VKM nr. 145, datë 13.03.2021, pika 2 – Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve</i> <i>Evidencë Nr. 4.10 – Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 – Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, efektiv apo me kontratë, përgjatë vizitës së GVJ u vu re se në disa raste sporadike kishte mangësi dokumentacioni nga Zyra e Burimeve Njerëzore pjesë e UA. Pavarësisht se Zyra e Burimeve Njerëzore kërkon dokumentacionin përkatës për të gjithë personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, disa nga dosjet e stafit PAE dhe PAK rezultuan të paplota, duke paraqitur mungesa të vogla në dokumentacion. Ndërkohë, stafi akademik me kohë të pjesshme dhe me kontratë afatshkurtër aplikon, si rregull, në fillim të çdo viti akademik. Fakulteti gjithashtu, disponon ngarkesën e stafit për secilin semestër (orët totale), angazhimin e tij në lëndët përkatëse, si edhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me Përgjegjësin e Departamentit në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. Referenca: <i>Shënime të përfuara gjatë takimit në UART</i> <i>Evidencë Nr. 4.0.2 – Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018</i> <i>Evidencë Nr. 4.11 – VKM Nr. 329, datë 12.04.2017</i> <i>Evidencë Nr. 4.12 – Urdhër i Rektorit për sistemimin e dosjeve të personelit</i>




Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Përgjatë takimeve të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVJ), stafi u njoh me mënyrën e organizimit të lëndës, kriteret e vlerësimit dhe dokumentimin e aktiviteteve të studentëve. Lënda “Praktikë Artistike” synon zhvillimin interpretativ të studentëve të programit Bachelor në “Perkusion”, përmes pjesëmarrjes aktive në koncerte si solistë, në ansamble apo orkestër. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), praktika zhvillohet gjatë tre semestrave të fundit dhe përfshin angazhim jashtë orarit të lëndëve “Instrument” dhe “Muzikë Dhome”. Në semestrin IV, studenti duhet të realizojë dy koncerte në formacione orkestrale, ndërsa në semestrin V dhe VI, një nga format e mëposhtme: një recital si solist, një koncert me ansambël muzike dhome, ose tre koncerte në orkestër. Koncertet mund të zhvillohen brenda ose jashtë UART, në bashkëpunim me institucione dhe formacione profesioniste. Për aktivitetet jashtë shkollës, kërkohet dokumentacion dëshmues (audio, video ose i shkruar). Lënda mbikëqyret nga pedagogu përgjegjës, i cili udhëzon dhe ndjek studentët në realizimin e praktikës.
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Ndërkohë, institucioni, si i vetmi që mbulon këtë gamë ekspertize dhe programesh artistike, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera kulturore dhe artistike, përmes të cilave lidh më ngushtë studentët me praktikën profesionale dhe jetën artistike jashtë mureve të shkollës. <i>Evidencë Nr. 2.14: Koncerte, festivale, aktivitete.</i> <i>Evidencë Nr. 2.15: Të dhëna mbi aktivizimin e studentëve që po frekuentojnë programin e studimit “Perkusion”.</i> <i>Evidencë Nr. 2.16: Projektet artistike të programit të studimit.</i> <i>Evidencë Nr. 2.17: Analizë e tregut të punës.</i>
Konkluzione	FM/UART, si institucioni i vetëm publik arsimor në fushën e artit, siguron që personeli akademik me kohë të plotë dhe kontratë jo vetëm që përputhet me fushat e studimit që ata mbulojnë, por gjithashtu kanë përvojë artistike dhe janë aktivë në fushën e artit. Universiteti i Arteve, në përputhje me kornizën ligjore, përcakton organizimin e brendshëm akademik dhe administrativ të tij, ku njësitë ndihmëse luajnë një rol të rëndësishëm. Për programin e studimit në Bachelor “Perkusion”, sipas planit mësimor, studenti duhet të realizojë praktikat




	<i>profesionale. Fakulteti i Muzikës, së bashku me koordinatorin e programit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe entitete private të fushës së muzikës, ku do të zhvillohet praktika mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës së kryer në Universitetin e Arteve, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstatoi se sallat dhe studiot në dispozicion të programit të studimit ishin në gjendje shumë të mirë, duke ofruar kushte të përshtatshme për zhvillimin optimal të procesit mësimor. Gjithashtu, gjatë vizitës, GVJ u informua se, në varësi të natyrës së përfundimit të lëndëve, studentëve u vihen në dispozicion edhe ambiente të tjera si Lektoriumi "Tonin Harapi", salla "Black Box" dhe Salla e Madhe e Koncerteve. Gjatë takimit u theksua gjithashtu se Universiteti i Arteve do t'i nënshtrohet një faze të dytë rikonstruksioni, që synon zgjerimin dhe modernizimin e mëtejshëm të hapësirave të institucionit. Evidencë Nr. 4.1.3: Të dhëna infrastrukturore për Fakultetin e Muzikës., Tabela 16
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë takimeve të zhvilluara me grupet përkatëse, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vërejtë se në Fakultetin e Muzikës, ambientet ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në "Perkusion" së bashku me programet e tjera të profileve të ngjashme janë të pajisura me infrastrukturë të përshtatshme për programin e studimit. Sallat dhe auditorët janë të pajisura me sistem audio dhe video, pulte dixhitale dhe të gjitha pajisjet e nevojshme për një proces mësimor cilësor dhe efikas. GVJ vizitoi të gjitha ambientet në dispozicion të programit të studimit "Perkusion". Në takimin me studentët, ai u informua që metodat e mësimdhënies ishin edhe të larmishme dhe eficiente. Në funksion të këtij programi janë gjithashtu dhe dy laboratorë lëndorë të dedikuar, të cilët mbështesin zhvillimin praktik dhe artistik të studentëve në përputhje me natyrën e specializuar të programit. Duke qenë se numri i studentëve në

	programin “Perkusion” është më i ulët krahasuar me programet e tjera, një vëmendje e veçantë i kushtohet punës së përbashkët praktike, duke shfrytëzuar gjithashtu laboratorë dhe ambiente të përbashkëta me programe të tjera studimi. Referenca Gjate Vizites ne UART Evidencë Nr. 4.13 Té dhëna infrastrukturePër Fakultetin e Muzikës, Tabela 16
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë takimit me grupet e pedagogëve dhe studentëve, u vlerësua fakti se zhvillimi i studimeve në programin “Perkusion” mbështetet nga kushte të përshtatshme infrastrukture dhe mjete të nevojshme didaktike. Në funksion të lëndëve speciale janë në përdorim dy studio të dedikuara, të pajisura me piano, bateri dhe amplifikatorë për bas elektrik, që shërbejnë për zhvillimin e mësimdhënies dhe aktiviteteve artistike. U theksua gjithashtu se veglat muzikore në përmasa më të vogla, si saksofoni apo basi elektrik, janë gjithmonë personale dhe të adaptuara sipas nevojave individuale të studentit, duke ndihmuar kështu në krijimin e një raporti të drejtpërdrejtë dhe efektiv me instrumentin. Studentët kanë në dispozicion edhe laboratorët e informatikës, sallën e internetit, bibliotekën me kompjuterë dhe sallën e produksionit audio. Gjithashtu, institucioni ofron hapësira të përbashkëta si Lektoriumi “Tonin Harapi”, salla “Black Box” dhe Salla e Madhe e Koncerteve, e cila pas rikonstruksionit të fundit ofron standarde të larta teknike duke shërbyer si hapësirë qendrore për shfaqjet artistike të UART. Evidenca Nr. 4.15 Salla me komiutera e bibliotekës
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Përgjatë takimit, grupi i GVJ u njoh me infrastrukturën teknike dhe mbështetjen që i ofrohet programit të studimit Bachelor në “Perkusion”. Ky program fokusohet në interpretimin me instrumente goditëse dhe nuk ka nevojë të drejtpërdrejtë për laboratorë të teknologjisë së informacionit. Megjithatë, studentët përfitojnë nga mundësitë që ofron Universiteti i Arteve për akses në informacion të përditësuar, përmes Bibliotekës së UART dhe laboratorëve të pajisur me programe profesionale si Sibelius, Cubase, Logic Pro dhe Max MSP. Fakulteti i Muzikës disponon dy laboratorë, përfshirë edhe një studio moderne për regjistrim dhe përpunim audio.

	Evidencë Nr. 4.16 Ambientet e Bibliotekës së UART Evidencë Nr. 4.17 Dokumentacioni me përshkrimin e aparaturave të studios marrë në dorëzim Evidencë Nr. 4.18 Foto nga procesi i përdorimit të programeve			
Konkluzione	Në përmbledhjen e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ çmon se Universiteti i Arteve (UART), përveç ofrimit të ambienteve të nevojshme për realizimin e procesit mësimor të programit Bachelor në "Perkusion", siguron gjithashtu zhvillimin cilësor të praktikave profesionale përmes bashkëpunimeve me institucione dhe struktura artistike që veprojnë në fushën e muzikës, duke mundësuar përfshirjen e studentëve në mjedise reale të performancës dhe krijimtarisë muzikore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Përgjatë takimit, GVJ u informua se literatura bazë dhe ndihmëse për çdo lëndë të programit Bachelor në "Perkusion" është e përfshirë në syllabus-in përkatës. Për shkak të mungesës së literaturës akademike në gjuhën shqipe për instrumentet e perkusionit, pedagogët përdorin burime të huaja dhe materiale ndihmëse. Partiturat dhe materialet për lëndët praktike janë të aksesueshme në Bibliotekën e UART, online dhe në bibliotekat personale të pedagogëve. Lëndët teorike bazë kanë literaturë në gjuhën shqipe, dhe Universiteti vijon të pasurojë fondin e bibliotekës për të mbështetur nevojat e studentëve. Gjithashtu, duhet pasqyruar saktë mënyra e dokumentimit të literaturës sipas strukturës javore të semestrit dhe vitit akademik. Evidencë Nr. 2.0.8: Syllabusi i lëndës "Instrument". Evidencë Nr. 4.1.9: Lista e literaturës në faqen e fundit të një syllabusi dhe lista zyrtare e bibliotekës me librat përkatës.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të	Gjatë vizitës, GVJ u njoh me fondin e pasur të bibliotekës dhe bashkëpunimin me Departamentin e Interpretimit për përditësimin e literaturës. U vlerësua përdorimi i literaturës nga studentët dhe përfshirja e sugjerimeve të pedagogëve dhe

literaturës me botime të viteve të fundit.	studentëve në këtë proces. Programi i studimit, i cili nuk fokusohet në teknologji, përfshin botime që ofrojnë qasje të ndryshme artistike dhe estetike, dhe lista e literaturës së detyrueshme është e specifikuar në syllabuse. Referenca Shenime gjate takimit Evidencë Nr. 2.0.8 Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve sipas Planit mësimor. Evidencë Nr. 4.19 Lista e literatures në faqen e fundit të një syllabusi dhe lista zyrtare e bibliotekës me libratpërkatës.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Përgjatë takimeve me pjesëtarët e Departamentit të Interpretimit, u theksua fakti se në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i syllabus-eve dhe përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse, në bashkëpunim me pedagogët përkatës. Ky proces mbështetet në botime të fundit dhe në sugjerimet e stafit akademik, me qëllim pasurimin e fondit të literaturës. U theksua gjithashtu se për shkak të natyrës së veçantë të programit "Perkusion", i cili nuk lidhet drejtpërdrejt me zhvillimet teknologjike, literatura e re shpesh pasqyron qasje individuale artistike. Studentët nuk janë të detyruar të ndjekin këto qasje, ndërsa lista e literaturës së detyrueshme përcaktohet qartë në syllabus-in e çdo lënde. Evidencë Nr. 4.20 Porosi Për libra të rinj nëse ka. Evidence Nr. 4.21 Lista e librave te rinj Pënr programin e studimit Perkusion.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës GJV konstatoi që ajo ishte e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Referenca: Evidencë Nr. 4.22: Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale. Evidencë Nr. 4.23: Fondet e aksesueshme të bibliotekës. Evidencë Nr. 4.24: Rregullore e bibliotekës.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e	Ky kriter përmbushet nëpërmjet abonimeve që institucioni ka realizuar në bibliotekat digjitale. Të gjithë studentët dhe stafi akademik kanë akses në këto burime përmes bibliotekës online

pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	të UART. Këto platforma shërbejnë si një burim i rëndësishëm për përgatitjen e leksioneve, materialeve ndihmëse dhe për zhvillimin e aktivitetit kërkimor-shkencor. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=344&niveli=74
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe teknologji të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët që e frekuentojnë atë. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në universitetin e Arteve biblioteka qëndron e hapur prej orës 8:00 - 19:00. Gjatë takimit me studentët ata pohuan për GVJ se ishin të kënaqur me shërbimet e bibliotekës. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe	Sipas RVB-së, çdo njësi bazë informohet rregullisht nga Biblioteka e UART për mundësitë dhe fondet në dispozicion për pasurimin e literaturës. Departamenti përkatës dorëzon periodikisht kërkesat për literaturën e nevojshme në funksion të zhvillimit të programit Bachelor në "Perkusion". Në kuadër të mbledhjeve të rregullta dhe procesit të rishikimit të syllabuseve, pedagogët e lëndëve propozojnë tituj të rinj, të cilët përcillen nga Përgjegjësi i Departamentit drejt Bibliotekës, në përputhje me fondet në dispozicion. Titujt e literaturës për këtë program janë të aksesueshëm edhe online, duke ofruar një pasqyrë të gjerë të burimeve në dispozicion të studentëve. Evidencë Nr. 4.3.0: Procedura e porosisë së librave (kërkesa nga pedagogu në departament – dërgimi në bibliotekë – foto e librit). Evidencë Nr. 4.3.1: Procedura e blerjes së partive dhe partiturave.

atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Evidencë Nr. 4.3.2: Raportimi (i Mirandës) për frekuentimin e bibliotekës fizikisht dhe online.			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që edhe për programin e studimit Bsc "Perkusion" biblioteka e institucionit ofron literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediseve mbështetëse të mësimnxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti i Arteve, disponon sistemin e menaxhimit në platformën "Pitagora". Nëpërmjet këtij sistemi administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim. Çdo student ka llogarinë e tij të dedikuar në këtë sistem. Në takimin me studentët, GVJ u informua që ky sistem funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevoiten atyre. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në	Çdo vit akademik, Departamenti i Interpretimit, në përputhje me udhëzimet dhe aktet ligjore në fuqi, përgatit dokumentacionin mbi ngarkesën mësimore dhe angazhimet e stafit akademik, përfshirë edhe veprimtari artistike apo shkencore. Këto dokumente integrohen në sistemin e brendshëm të menaxhimit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, së bashku me CV-të dhe materialet mbështetëse të stafit. <i>Gjatë takimeve të zhvilluara me zyrën e burimeve njerëzore, GVJ vërejti se disa nga dosjet e stafit PAK paraqisnin mungesa në dokumentacionin përkatës.</i> Informacioni për stafin dhe studentët ofrohet përmes sistemit PITAGORA, i cili mundëson akses në njoftime mbi provimet, notat, vërtetime dhe rezultate në kohë reale. Për më tepër, informacioni publikohet edhe në faqen zyrtare të universitetit.

informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit "Pitagora" është i instaluar në platformën "Microsoft Office 365" dhe arrihet nëpërmjet adresës së dedikuar për çdo individ. Ai përmban module insertimi, leximi dhe editimi, të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Sistemi mundëson shkëmbim e materialeve didaktike, komunikim, realizimin e konsultimeve audio-vizuale online, përdorim të paketës office, akses në email-in universitar, etj. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 4.3.6 – Fotot nga sistemi PITAGORA – Vlerësimi i pedagogut, pasqyrim tek studenti Evidencë Nr. 4.3.7 – Manuali PITAGORA
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit "Pitagora" garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Informacionet jepen nëpërmjet domenit https://uart.pitagora.rash.al/login, i cili i afishon ato në rubrika të posaçme. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://uart.pitagora.rash.al/login
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Universiteti i Arteve ka domenin e tij në internet, platforma google, i cili arrihet në adresën http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=121&niveli=19. Në këtë adresë gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në rang institucioni, njësisht kryesore, njësisht përgjegjëse, programesh studimi, partnerët strategjikë etj. GVI e vizitoi këtë faqe dhe konstaton plotësimin e kriterit. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -https://uart.pitagora.rash.al/login

	-http://uart.edu.al/index.php			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti i Arteve disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional Pitagora dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ edhe për programin e studimit BSC "Pitagora".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në lidhje me hartimin e një raporti financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Gjithashtu përpara fillimit të çdo viti akademik hartohet buxheti vjetor i programit bazuar në objektivat dhe programin mësimor të programit të studimit. Buxheti merr parasysh kërkesën dhe nevojën për burime njerëzore akademike dhe administrative në shërbim të programit, burime infrastrukturore, logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku përfshihen pajisje për klasat, laboratore dhe investime të tjera. Buxheti gjithashtu parashikon burimet e financimit të kostove të përmendura mësipër. GVJ rekomandon fuqizimin e burimeve të tjera financiare me qëllim që të rritet siguria në jetëgjatësinë e programit. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidence Nr. 4.4.1 – Kërkesa e Dekanit drejtuar Administratorit Evidence Nr. 4.4.2 – Tabelat për projektbuxhetin Evidence Nr. 4.4.3 – Vendimi i Senatit mbi miratimin e projektbuxhetit Evidence Nr. 4.4.4 – Vendimi i Bordit të Administrimit për projektbuxhetin Evidence Nr. 4.4.5 – Rregullore të Bordit të Administrimit

Kriteri 2. Plani i financimit të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Shpenzimet për burimet njerëzore, akademike dhe administrative që i shërbejnë programit vijnë me kërkesë të paraqitur nga Njësia Bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Perkusion”. Për këtë program, Njësia Bazë mbulon financiarisht stafin akademik me kohë të plotë; ndërkaq stafi me kohë të pjesshme gjenerohet nga vetë të ardhurat e insitucionit. Gjithashtu përgjatë vizitës në lidhje me mbështjen për buxhet për shpenzimet lidhur me mjediset apo teknologjite e reja, merren në konsiderate. Për të siguruar një mbarrëvajtje të programit të studimit gjithmonë në lidhje me financimin për stafin; përmisimin dhe kualitetin e mësimdhënies; mjediset; mjetet; sygjerohet të zhvillohen shkëmbime stafi me profile studimi të së njëjtës trajtë studimi; apo pjesëmarrje në projekte të cilat do të mundësonin një vazhdimësi të sigurt për programin në koherencë me zhvillimet më të fundit në fushën e muzikës. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UART nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Drejtorja e financave dhe bordi i administrimit janë njësitë të cilat miratojnë dhe shpërndajnë grantet në UA. Për të diversifikuar burimet e të ardhurave, sygjerohet më tej të ardhurat dytësore në mënyrë që të ulët risku i “goditjeve” nga rëniet e përkohshme të numrit të studentëve, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në projektet e financuara nga donatorë si EU, IIK, SIDA etj. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 4.50: Udhëzimi MAS nr. 5, datë 10.02.2018, për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL-ve.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë	GVJ u informua se Universiteti i Arteve demonstroi stabilitet financiar, duke përmbushur në mënyrë të vazhdueshme nevojat

financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	e stafit akademik dhe të studentëve, sipas planifikimeve buxhetore dhe mundësive të ofruara nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e gjeneruara nga vetë institucioni. Si një institucion i arsimit të lartë, pranimi në UART është i bazuar në talentin e konkurrentëve dhe realizohet përmes konkursit. Për shkak të numrit të kufizuar të shkollave të mesme me profil artistik në vend, të cilat përgatisin kandidatët për UART, numri i studentëve në këtë institucion është relativisht i vogël. Kjo situatë ndikon në kufizimin e të ardhurave dytësore nga tarifat e regjistrimit dhe shkollimit. Për këtë arsye, duhet parë aspekti i financimeve nga projekte ndërkombëtare, të cilat përfshijnë fushën e artit, për të filluar dhe siguruar vazhdimësinë në aspektin e materialeve dhe veglave muzikore për studentët e këtij programi. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ofrimit të mundësive më të mira për zhvillimin profesional të studentëve, duke i mundësuar atyre qasje në burime moderne dhe të avancuara për studimin e muzikës.			
Konkluzione	<i>Në vlerësimin e përgjithshëm të përmbushjes së kërkesave të këtij standardi, GVJ konstatoi se Universiteti i Arteve, në lidhje me hartimin e raportit financiar për kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, dhe planin për mbështetje financiare, ka një strukturë financimi të diversifikuar. Burimet e financimit për Njësinë Bazë përfshijnë grante nga buxheti i shtetit, të ardhura të krijuara nga institucionet dhe burime të tjera me destinacion të caktuar. Për programin e studimit dhe njësinë përkatëse, projekt-buxheti afatmesëm dhe ai vjetor hartohen nga administratori i Universitetit të Arteve, nëpërmjet drejtorisë ekonomike. Planifikimi financiar fillon çdo vit kalendarik, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe udhëzimet përkatëse të lidhura me të. GVJ sugjeron që të bëhet një diversifikim më i madh i burimeve financiare, me qëllim që të ardhurat nga tarifat e studentëve të mbeten të përballueshme për ta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në Universitetin e Arteve, përfshirë Fakultetin e Muzikës, formimi i studentëve nga pranimi deri në përfundim të studimeve mbështetet në Rregulloren e programit të studimit. Rregullorja për programin B.Sc. në "Perkusion" është hartuar bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, aktet nënligjore dhe VKM Nr. 145, datë 13.03.2021, si dhe në Rregulloren e Departamentit të Interpretimit. Ajo miratohet në Dekanat dhe Senat, duke respektuar natyrën specifike të programit. Për pranimin në këtë program, studentët i nënshtrohen konkurseve të organizuara çdo vit, sipas një rregulloreje të veçantë që miratohet nga Senati dhe publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata i njohnin këto procedura dhe konfirmonin që zbatimin e tyre ishte në dobi të gjithë aktivitetit të tyre në institucion. <i>Evidencë Nr. 2.0.5 – Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë."</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.2 – VICM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë."</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.1 – Statuti i UART.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.8 – Rregullore e B.Sc. "Perkusion", Neni 8, Neni 9.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Jo vetëm në dokumentacionin e konsultuar por edhe në takimet në insitucion, kryesisht gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bsc "Perkusion". Si të drejtat ashtu edhe detyrimet ishin të njohura nga studentët edhe nëpërmjet dokumentacionit të publikuar nga institucioni, edhe nga veprimtaria konkrete që zhvillohej gjatë kohës së studimeve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të konsulencës nga zyrtarë përkatës. Referuar RVB dhe vizitës në institucion GVJ u informua që Universiteti i Arteve bazuar në kërkesat e MAS, rregulloren didaktike, rregulloren e programit Bsc "Perkusion", me propozim

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	të departamentit të Interpretimit, miratim të fakultetit dhe vendim të Senatit Akademik, përcakton kriteret e pranimit dhe kuotat e pranimit për kandidatët që duan të studiojnë në PS Bsc "Perkusion". Si dhe kriteret për konkursin përkatës për këtë program studimi. Gjithashtu gjatë takimit GVJ evidentoi faktin se tashmë është bërë traditë dhe aspekti i integritetit të OPEN Day për UART, si dhe pjesëmarrje në panairët e karrierës nëpërmjet njësive përkatëse. Në takimin me studentët, GVJ konstaton që ata janë njohur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe në plotësim të tyre. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 5.0.1 – Faqja zyrtare e Universitetit të Arteve: http://uart.edu.al/index.php Evidencë Nr. 4.0.4 – Rregullore e UART: http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=987&niveli=127 Evidencë Nr. 5.0.2 – Vendime të Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administratës: http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=544&niveli=142 Evidencë Nr. 1.0.6 – "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës." Evidencë Nr. 5.0.3 – Rregullore për zhvillimin e konkursit në ciklin e parë Bachelor. Evidencë Nr. 5.0.4 – Miratimi i tarifave të konkurrimit, të regjistrimit dhe të shkollimit për vitin 2022-2023. Evidencë Nr. 5.0.5 – Deklarimi i kuotave të pranimit për vitin akademik 2023-2024.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UART, sipas kuotave të miratuara, ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve midis programeve të të njëjtit cikël studimi në fusha të përafërta, brenda ose jashtë institucionit. Vendimmarrja për njohjen e krediteve bëhet nga një komision i posaçëm i departamentit përkatës, ndërsa vendimi përfundimtar merret nga Dekani. Studentët informohen rreth procedurave të transferimit, megjithatë rastet janë të rralla për shkak të natyrës së veçantë të programeve artistike që ofron Universiteti i Arteve, i vetmi institucion publik i këtij profili në vend. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 5.0.3 – Rregullore për zhvillimin e ciklit të parë Bachelor.




	<i>Evidencë Nr. 1.0.6 – "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës".</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.5 – Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve, Neni 24.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Duke iu referuar dokumentacionit të konsultuar, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe publikimeve në faqen zyrtare http://www.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=206&niveli=84, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. Të gjitha kërkesat referohen në dispozitat ligjore dhe interesat e institucionit për të tërhequr kontigjentë sa më cilësorë. Për kandidatët e pranuar shërben Zyra e Pranimeve, e cila u jep atyre informacione të detajuara për universitetin dhe njësitë e tij si dhe për programin e studimit përkatës. Përgjat takimit, GVJ u informua se Universiteti i Arteve organizon "Open Day", duke hapur dyert për publikun dhe nxënësit e shkollave të ciklit të ulët, të interesuar për të ndjekur studimet në fushën e arteve. Referenca: <i>Evidencë Nr. 5.0.7 – VSA Nr. 11, datë 09.02.2023, mbi përcaktimin e pikëzimit në konkurset e pranimit.</i> <i>Evidencë Nr. 5.0.8 – VSA Nr. 12, datë 09.02.2023, mbi propozimin për miratimin e tarifave të konkurrimit, tarifës së regjistrimit, tarifës së shkollimit.</i> <i>Evidencë Nr. 5.0.8.1 – Open Day, Koncerti Jazz i Open Day – foto.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Gjatë takimit të zhvilluar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), Universiteti i Arteve informoi se, si institucioni i vetëm publik që ofron arsim të lartë në fushën e arteve, në përputhje me parimin e barazisë, nuk kishte përcaktuar kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve nga grupet minoritare, shtresat e marginalizuara apo me aftësi të kufizuara. Në vend të kësaj, ishin përcaktuar kuota të dedikuara pranimi për këto kategori, me qëllim garantimin e aksesit të barabartë në programet e studimit. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion <i>Evidencë Nr. 5.12 – VSA Nr. 17, datë 10.03.2022.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e	Për kandidatët nga shtete të tjera që kërkojnë të aplikojnë në programin e studimit Bsc. "Perkusion", Universiteti i Arteve (UART) përcakton dhe publikon çdo vit akademik kriteret përkatëse të pranimit. Këto kriteret bëhen të disponueshme në ambientet e institucionit, në faqen zyrtare të universitetit, përmes njoftimeve me e-mail dhe rrjeteve sociale. Gjatë takimit me GVJ,

kandidatëve nga shtete të tjera.	u konfirmua se informacioni përkatës gjendet në faqen zyrtare të UART. Megjithatë përtej faktit se ky program kuotat i ka shumë të ulëta, deri më tani, nuk është regjistruar asnjë student i huaj në këtë program. Një veçori e kandidatëve që aplikojnë është synimi për t'u përfshirë sa më shpejt në tregun e punës, i cili, sipas deklarimeve të studentëve, shfaq interes për këtë profil. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti i Arteve ofron bursa për studentët që përfshijnë kategoritë e mëposhtme: Bursa për studentët në nevojë: • Studentë nga familje që marrin ndihmë ekonomike; • Bashkëshortë me fëmijë që janë të dy studentë në universitete publike; • Studentë me aftësi të kufizuara; • Studentë që kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara; • Studentë që kanë një prind pensionist dhe prindin tjetër të ndjerë; • Studentë që kanë të dy prindërit pensionistë; • Studentët, të tretët ose më lart, nga familje me tre ose më shumë fëmijë, ku dy të parët janë studentë në universitete publike; • Studentët që kanë statusin e jetimit deri në moshën 25 vjeç; • Studentë që kanë humbur përgjegjësinë prindërore përmes vendimit të gjykatës deri në moshën 25 vjeç; • Studentë të identifikuar si viktimat e trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç; • Studentë që janë fëmijë të forcave të rendit të rënë në detyrë; • Studentë romë dhe egjiptianë; • Fëmijët e ish të dënuarve politikë; • Studentë me një prind me aftësi të kufizuara që përfitojnë pagesën për aftësi të kufizuara. Bursa sipas meritave: • Studentë të vitit të parë me mesatare mbi 9; • Studentë të vitit të dytë ose të tretë me mesatare mbi 9. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 5.0.9 – VKM Nr. 780, datë 26.12.2018, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e




	<i>bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë."</i>			
Konkluzione	Në përfundim të shqyrtimit të përmbushjes së këtij standardi, GVJ vlerëson se Universiteti i Arteve zbaton politika dhe procedura të qarta institucionale për pranimin, përzgjedhjen, përparimin, transferimin, njohjen dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, si dhe për diplomimin e tyre. Këto procedura janë të standardizuara dhe sigurojnë funksionimin e qëndrueshëm të programit të studimit Bachelor në Perkusion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregulloret e përgjithshme dhe rregullorja e programit të studimit përshkruajnë me imtësi modalitetet e përparimit akademik: - Rregullorja e UART - Rregullorja e ciklit të parë të programeve Bachelor - Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore - Rregullorja e Departamentit të Interpretimit - Rregullorja e programit të studimit Gjithashtu, në kontakt të vazhdueshëm me studentët është edhe personeli i departamentit dhe i programit të studimit, që informon studentët dhe trajton çështje specifike gjatë procesit mësimor. Studentët informohen për përparimin e tyre dhe kriteret dhe procedurat e vlerësimit përmes: • Informacionit të dhënë në klasë nga stafi pedagogjik; • Informacionit të ofruar përmes sekretarisë mësimore; • Informacioni i marrë në ëeb dhe përmes sistemit PITAGORA; • Informacionit të dhënë në Departamentin e Interpretimit; Gjatë takimit me studentët, GVJ vërejti se studentët ishin të informuar mirë.

	Evidencë Nr. 1.0.6 – "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës", Kreu V, Nenet 41, 42, 43, 44. Evidencë Nr. 1.0.8 – "Rregullore mësimore e Programit të Studimit Bachelor 'Perkusion", Nenet. Evidencë Nr. 5.11 – Sistemi PITAGORA, https://uart.pitagora.rash.al/login. Evidencë Nr. 3.11 – Faqja e ëeb-it të Fakultetit të Muzikës, Rubrika "Informacion/datat e provimeve", https://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=78&niveli=69.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në UART pranohen transferime të studentëve nga universitete dhe shkolla të tjera arti, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, dhe lejohet largimi i studentëve për në institucione të tjera të arsimit të lartë, sipas procedurave të parashikuara. Për të transferuar studimet në UART, studenti duhet të ketë marrë të paktën 48 kredite në programin përkatës. Fakulteti mund të njohë kreditet e fituara nëse ato përputhen me kriteret e ekuivalentimit të lëndëve. Komisioni i njohjes dhe ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani, shqyrton dhe vendos për njohjen e krediteve dhe lëndëve, duke marrë parasysh përputhshmërinë e programeve dhe krediteve. Në rast të njohjes së pjesshme, studentit mund t'i caktohet shlyerja e pjesës së mbetur të programit, me mundësi për të realizuar provime ose detyra të tjera të përcaktuara nga komisioni. Në dokumentacionin bazë të institucionit jepen informacionet që lidhen me kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Këto informacione merren edhe tek zyrat përkatëse të institucionit si Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 2.12 – Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve, Neni 24.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në aktet rregullatore të UART, janë përcaktuar format e mësimit dhe kontrollit (Rregullorja e programit, neni 11), të cilat janë përfshirë në syllabusin e çdo lënde dhe shpallen nga pedagogu. Puna mësimore përfshin një larmi formash të kontrollit të dijeve, si: bashkëbisedime, kontrolle teknike, mbrojtje të ecursisë së detyrave, provime të ndërmjetme dhe provime kursi, aktivitete artistike (koncerte, workshope, masterclass, etj.). Kontrolli i dijeve mund të bëhet nëpërmjet provimeve me shkrim, me gojë, vlerësimit të detyrave dhe projekteve muzikore, ose provimeve në grup. Organizimi i

	provimeve është i përshtatshëm për secilën disiplinë dhe pasqyrohet në syllabus. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 2.0.8 Planit mësimor dhe syllabuset e lëndëve sipas Planit mësimor Evidencë Nr. 1.0.6 Rregullore e programit Bachelor Perkusion Neni 11
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Gjatë takimeve, GVJ u informua si nga stafi ashtu edhe nga studentët se modaliteti i diplomimit është parashikuar dhe përcaktuar në Rregulloren e programit Bsc. në "Perkusion", neni 25 dhe 26. Provimi i diplomës realizohet me mbrojtje artistike të diplomës në formë koncerti, sipas syllabusit të Punimit të diplomës. në rastin e studentëve të programit studimor "Perkusion" provimi dhe mbrojta zhvillohet në formatin e koncertit si pjesë e një trupe asambli. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet dhe të kenë grumbulluar kreditet përkatëse për të mbrojtur temën e diplomës. Fakulteti i Muzikës njofton studentët për temat dhe programet e diplomës brenda dy muajve nga fillimi i vitit akademik. Mbrojtja e diplomës përfshin: përgatitjen e aranzhimeve muzikore, provat në ansambël, organizimin e koncertit dhe regjistrimin e tij. Përgatitjet ndiqen nga pedagogu udhëheqës i diplomës. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 1.0.8 – Rregullore e programit Bachelor "Muzikë Jazz", Neni 25 dhe Neni 26. Evidencë Nr. 5.12 – Syllabusi i punimit të diplomës.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në universitetin e arteve ky kriter plotësohet duke organizuar për studentët ditët e hapura të dedikuara për çdo program studimi në mënyrë që studentët të njihen më nga afër me infrastrukturën e universitetit, ambjentet laboratorike, ateliet, e sallat, kurrikulën e programit, akreditimin institucional etj. Po ashtu studentët pajisen me guidën e studentit si dhe u rekomandohen rubrikat përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Universiteti i Arteve merr pjesë edhe në panairët informuese të organizuara në qytetet e ndryshme të vendit, ku përveç përfaqësuesve të zyrës së pranimeve është i pranishëm edhe një përfaqësues i personelit akademik, për të informuar mbi ofertat mësimore të universitetit.




	<i>Evidencë Nr. 5.13 – Fletëpalosje mbi informimin e studentëve të ardhshëm lidhur me programet e studimit të ofruara nga UART.</i> <i>Evidencë Nr. 5.14 – Foto, dokumenta/publikime nga takimet e pedagogëve në shkollat e mesme artistike.</i>			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti i Arteve vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bsc "Perkusion", informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit "Perkusion" përmes takimeve në shkollat e mesme artistike, ditëve të hapura në Fakultetin e Muzikës, gjatë regjistrimit dhe javës së parë të vitit akademik, si dhe nëpërmjet orientimeve të vazhdueshme nga pedagogët. Të dhëna të plota janë të disponueshme edhe në faqen zyrtare të UART në seksionin e Departamentit të Interpretimit. Gjatë takimeve të kryera me grupet e punës në UART si dhe studentet, GVJ u njoh me faktin se në shkollat e mesme artistike, ka mungesë së stafit dhe njohurive, për këtë specifike instrumenti, pavarësisht rëndësisë dhe pjesës integrale që ajo ka. <i>Evidencë Nr. 5.15 – Faqja e ëeb-it e Departamentit të Interpretimit</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=193 <i>Evidencë Nr. 2.0.2 – Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	Studentët njihen me planin mësimor të profilin të tyre, syllabuset e çdo lënde, veprimtaritë përkatëse mësimore (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra) dhe procedurat e vlersimit të njohurive. Këto informacione u transmetohen atyre në mënyrë të vazhdueshme qysh me fillimin e programit të studimeve e deri në diplomim. Sipas profilin të tyre, studentët udhëzohen ti gjejnë këto informacione

përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	edhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ konstaton që ata i zotërojnë të gjitha informacionet e kërkuara. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 2.0.2 – Plan i mësimor i programit të studimit Evidencë Nr. 2.0.8 – Syllabuset e lëndëve Evidencë Nr. 5.0.1 – Faqja zyrtare e Universitetit të Arteve <u>ëëë.uart.edu.al</u>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Programi Bsc në "Perkusion" është një profil i cili ka nisur që me fillimet e vetë universitetit dhe në Fakultetin e Muzikës, që synon përgatitjen e muzikantëve të kualifikuar në muzikën moderne, duke plotësuar një boshllëk në tregun e punës. Studentët informohen për mundësitë e punësimit në institucione kulturore publike dhe private, media, orkestra, shkolla artistike e jo-artistike, si dhe në produksione muzikore kombëtare e ndërkombëtare. GVJ konstatoi, në varësi edhe të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe takimeve të zhvilluara, që ky program është i orientuar drejt tregut të punës dhe u ofron studentëve perspektiva të qarta punësimi, sepse është një fushë studimi shumë specifike. Informacioni për programin është i aksesueshëm edhe në faqet zyrtare të UART dhe në sekretariatë mësimore. Evidencë Nr. 5.16 – Faqja zyrtare e Universitetit të Arteve: Njoftime për aplikime <u>http://uart.edu.al/index.php</u> Evidencë Nr. 5.17 – Faqja zyrtare e Universitetit të Arteve: Njoftime për studentët dhe Platforma GRADUA <u>http://uart.edu.al/index.php?niveli=69</u>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Të gjithë studentët e PS e Bsc "Perkusion" kanë akses në sistemin interaktiv të universitetit "Pitagora", ku gjejnë të gjitha informacionet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Po ashtu, në dispozicion të tyre janë edhe zyrat përkatëse në institucion të cilat i ofrojnë këto shërbime sa herë u kërkojnë nga të interesuarit. Evidencë Nr. 5.19 – Faqja zyrtare e Fakultetit të Muzikës: Orari i studimeve <u>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=611&niveli=68</u> Evidencë Nr. 5.20 – Faqja zyrtare e Fakultetit të Muzikës: Datat e provimeve <u>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=78&niveli=69</u>




	Evidencë Nr. 5.16 Faqja e ëeb-it Departamenti i Interpretimit http://uart.edu.al/index.php_ & id=193 &niveli = 72			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Plani mësimor, lëndët, kreditet dhe syllabus-et janë të aksesueshme në sistemin PITAGORA dhe faqen zyrtare të UART, duke i ndihmuar studentët të organizojnë angazhimet akademike. Evidencë Nr. 5.21 – Faqja zyrtare e Fakultetit të Muzikës: Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Perkusion”. Evidencë Nr. 5.12 – Faqja zyrtare e Universitetit të Arteve: Sistemi PITAGORA – https://uart.pitagora.rash.al/login.			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmblendhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti i Arteve vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bsc “Perkusion” informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në universitet se sekretaria mësimore mbledh dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët dhe performancën e tyre. Ky program nuk ka ende të diplomuar.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit	Gjatë vizitës në UART, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.




apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Programi i studimit ka pasur gjithsej 5 studentë të regjistruar: 2022-2023 3 studentë; 2023-2024 0 studentë; 2024-2025 2 studentë. Në këtë program nuk rezultojnë transferime apo dhe largime, referuar tabelës (Tabela 21) në RVB. Këto të dhëna i referohen shtojcave të RVB si dhe ruhen në sekretarinë mësimore sipas formateve standarde të MAS dhe QSHA. Evidenca Tabela 21.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore ruan të dhënat për të gjithë studentët. Kjo përfshin statusin, notat, frekuentimin, dhe informacionet e tjera të rëndësishme për avancimin e studentit. Pjesa e këtyre të dhënave është e dukshme për studentët përmes sistemit PITAGORA, të mundësuar nga RASH, ndërsa të tjera janë të aksesueshme nga stafi i specializuar që mund të krijojë statistika ose analiza të të dhënave. GVJ konstatoi gjatë vizitës se sekretaria mësimore gjithashtu ruan të dhënat zyrtare në letër, sipas formateve standarde të kërkuara. Përveç përfaqësimit në organet vendimmarrëse, studentët kontribuojnë në vlerësimin e procesit akademik përmes sondazheve të Sektorit Mësimor, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e programeve dhe mësimdhënies. Evidencë Nr. 5.12 Faqja e web-it të UART, sistemi PITAGOIU. https://uart.pitagora.rash.al/login
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Gjatë vizitës, GVJ u njoh me mënyrën e funksionimit të Sektorit Mësimor, i cili, sipas rregullores së miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve, është përgjegjës për kryerjen e kontroleve periodike në të gjitha njësitë përgjegjëse, përfshirë sekretaritë mësimore dhe sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit. Ky sektor monitoron dhe dokumenton rregullisht saktësinë e të dhënave që lidhen me studentët dhe veprimtarinë e tyre akademike. Gjatë takimeve, u evidentua se Sektori Mësimor kryen kontrole mbi regjistrat e notave dhe verifikon përputhshmërinë e tyre me regjistrimet e bëra nga stafi i sekretarive mësimore, duke garantuar integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave akademike në institucion. Evidencë Nr. 5.23 Rregullorja e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.Neni 5, pika 14.




Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë vizitës, GVJ u njoh me veprimtarinë e Sektorit Mësimor, i cili, sipas rregullores së miratuar nga Senati Akademik, kryen kontrole periodike në njësitë përgjegjëse dhe sekretariatë mësimore për të verifikuar saktësinë e të dhënave akademike të studentëve. Ky sektor siguron përputhshmërinë e regjistrimeve me dokumentacionin përkatës, duke garantuar integritetin e procesit mësimor. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencë Nr. 1.19 – Raporti i analizës vjetore të punës së njësisë bazë.			
Konkluzione	<i>GVJ vizitoi sekretarinë mësimore dhe shqyrtoi me hollësi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga universiteti. Bazuar në sa më sipër konstatojmë se të dhënat ruhen si në formë të printuar ashtu edhe në formë digjitale. Të dhënat janë të detajuara dhe lehtësisht të aksesueshme. Universiteti prodhon raporte dhe analiza periodike bazuar në të dhënat e ruajtura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Pjesëmarrja e studentëve në jetën institucionale të Universitetit të Arteve është thelbësore. Ata janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisionet e Përhershme për Sigurimin e Cilësisë dhe Marrëdhëniet me Studentët, si dhe në Këshillin Studentor. Përmes përfaqësuesve të tyre, studentët mund të japin mendime dhe propozime për çështje që lidhen me jetën akademike dhe institucionale. Universiteti mbështet aktivisht Këshillin Studentor dhe inkurajon përfshirjen e studentëve në aktivitetet artistike, ku shpesh bashkëpunojnë me pedagogët si pjesë e barabartë e projekteve. Evidencë Nr. 2.0.5 – Ligji nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në




	Republikën e Shqipërisë”, Kreu IX. Evidencë Nr. 1.0.1 – Statuti i Universitetit të Arteve të Tiranës (UART). Evidencë Nr. 5.23 – Fotografi nga koncertet me pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga takimi me studentët rezulton se ata janë të vetëdijshëm për përfaqësimin e tyre dhe e gjejnë deri diku efikase mënyrën si adresohen problemet dhe mendimet e tyre. Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohet. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Departamenti Interpretimit është në komunikim të vazhdueshëm me studentët përmes aktiviteteve mësimore. Sektori mësimor gjithashtu realizon sondazhe mbi programin e studimit me studentët dhe personelin akademik. Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohet. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas. Evidenca Nr. 5.24 – Pyetësori për studentët. Evidenca Nr. 5.25 – Raporti mbi gjetjet e pyetësorit të studentëve.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësise/pedagogut përgjegjës.	Referuar rregullores së programit të studimit, Neni 45, përcaktohen mënyrat e vlerësimit të studentit dhe mundësitë e ankimit. Komunikimi i rezultateve bëhet në një seancë të posaçme ku studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin dhe të shprehë mendimin e tij. Brenda 24 orëve nga marrja e rezulttit, studenti ka mundësi të ankohet për rezultatin. Në këto raste, Dekani verifikon rastin dhe jep edhe vlerësimin përfundimtar. Gjatë vizitës së GVJ, nuk u identifikua asnjë rast konkret ankimi. Evidence Nr. 1.0.6: Rregullorja e programit të studimit BSc në Perkusion Evidence Nr. 1.0.5: Rregullorja e veprimtarisë së

	<i>përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, Kreu V, neni 45, pikat 12, 13, 14, 15, 16.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar mirë dhe të angazhuar në nivele të ndryshme si një pjesë e rëndësishme e universitetit dhe e programit specifik. Studentët janë të përfaqësuar drejtpërdrejt por edhe indirekt përmes kontaktit të vazhdueshëm me personelin akademik. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, për shkak të shkallës së vogël, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ, përgjatë takimeve dhe në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, konstatoi se Universiteti i Arteve ka ngritur struktura funksionale për informimin dhe mbështetjen e studentëve, si Sekretaria Mësimore dhe Sektori Mësimor. Këto njësi ndjekin dhe dokumentojnë ecurinë akademike të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke ofruar asistencë për çështje akademike e administrative. Informimi realizohet në mënyrë të rregullt përmes faqes zyrtare të institucionit, postës elektronike, njoftimeve në stenda dhe kontakteve të drejtpërdrejta me pedagogët. <i>Evidencë Nr. 3.22 – Rregullorja për Funksonimin e Sekretarisë Mësimore.</i> <i>Evidencë Nr. 5.23 – Rregullorja për Funksonimin e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë	Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me strukturën e universitetit dhe rezultojnë të jenë të informuar mirë dhe të kënaqur me nivelin e komunikimit dhe ndihmës. Ata marrin informacionin kryesor përmes internetit (web dhe social media) dhe sistemit PITAGORA, i cili u mundëson atyre të aksesojnë të dhëna dhe informacionet e rëndësishme për avancimin e tyre individual në program. Nga ana tjetër, Sekretaria Mësimore, Sektori Mësimor dhe Departamenti




me procesin mësimor dhe programin e studimit.	duket se janë efikasë dhe të dobishëm në procesin e informimit dhe këshillimit. <i>Evidencë Nr. 5.16 – Faqja zyrtare e Departamentit të Interpretimit:</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=193&niveli=70 <i>Evidencë Nr. 3.13 – Faqja e ëeb-it e Fakultetit të Muzikës, rubrika "Informacion":</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=75&niveli=66 <i>Evidencë Nr. 5.12 – Sistemi PITAGORA i UART:</i> https://uart.pitagora.rash.al/login
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Sektori Mësimor, ku përfshihen struktura e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, është përgjegjës për informimin dhe asistencën e studentëve për aktivitetet e përditshme brenda universitetit. Në rregulloren e tij thuhet: Zyra mësimore, informimit të studentëve, karrierës dhe alumni. zbaton detyrat si më poshtë: Mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e arit dhe të kulturës. Përditëson bazën e të dhënave të institucioneve me të cilat UART ka marrëveshje bashkëpunimi, të cilat kanë në funksion Karrierën dhe punësimin e ardhshëm të të studentëve të UART. Në rastin e programit të studimit, një pjesë e studentëve fillojnë të lidhen me tregun e punës para diplomimit. Tregu i punës është ende i etur për profesionistë të rinj, kështu që në këtë rast, puna e zyrës së karrierës është disi më e lehtë. <i>Evidencë Nr. 5.23 – Rregullore për Funksionimin e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</i> <i>Evidencë Nr. 2.12 – Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në Universitetin e Arteve, Neni 40.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e	Gjatë takimeve, GVJ u vu në dijeni se Universiteti i Arteve ka krijuar një strukturë të dedikuar për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni-n, e cila mban lidhje të ngushta dhe të vazhdueshme me ish-studentët. Kjo strukturë ka zhvilluar një bazë të dhënash të pasur, duke përfshirë informacion të detajuar mbi punësimin e tyre, vazhdimin e studimeve, dhe çdo zhvillim tjetër të rëndësishëm në karrierën e ish-studentëve. Këto të dhëna mbledhen përmes komunikimeve të rregullta me

autoriteteve drejtuese përkatëse.	ish-studentët, duke përdorur mjete të ndryshme si adresat e e-mailit, kontaktet telefonike, dhe rrjetet sociale. Evidenca Nr. 5.23 – Rregullorja e Funkcionimit të Sektorit Mësimor. Evidenca Nr. 5.27 – Të dhëna mbi alumni (tabela 23).			
Konkluzione	GVJ konstatoi se Universiteti i Arteve ofron një ambient edukativ të strukturuar dhe funksional për studentët, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme përmes Sektorit Mësimor dhe Sekretarisë Mësimore, në bashkëpunim me departamentet përkatëse. Këto struktura ofrojnë mbështetje të plotë për çështje akademike dhe administrative, duke siguruar një ndërveprim të vazhdueshëm dhe efikas me studentët. Takimet e realizuara me studentët tregojnë se ata kanë mundësi të komunikojnë lehtësisht dhe të zgjidhin çdo problem që lidhet me studimet e tyre, duke kontribuar në një proces edukativ pa pengesa. Kjo mbështetje është një element kyç për suksesin dhe cilësinë e programit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Universiteti i Arteve përdor metoda inovative mësimdhënieje për programin BSC në "Perkusion", ku pedagogët krijojnë qasje të personalizuar për secilin student. Ky program ofron metoda të reja në muzikën klasike, përfshirë ansamble dhe orkestër. Gjatë vizitave të grupit të punës dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, leksionet online u mbajtën përmes sistemit Microsoft Teams, i zhvilluar nga Rektorati dhe sektori i TI.

	<i>Evidencë Nr. 6.0.1: Manuali i përdorimit të sistemit të Microsoft Teams</i> <i>Evidencë Nr. 2.0.8: Plani mësimor dhe syllabuset për Perkusion</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ u informua në lidhje me mekanizmat e përdorur për monitorimin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së programeve të studimit dhe aftësive mësimdhënëse, përmes sondazheve dhe pyetësorëve të zhvilluara me studentët dhe pedagogët nga Sektori Mësimor dhe departamentet përkatëse. Gjatë takimeve, u theksua rëndësia e mbështetjes për kualifikimin e personelit akademik dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet departamenteve. Për më tepër, GVJ u njoh me analizat vjetore të punës, që përfshijnë rekomandime për përmirësimin e proceseve mësimore dhe aftësive mësimdhënëse. <i>Evidencë Nr. 6.0.3 Pyetësori për stafin akademik.</i> <i>Evidencë Nr. 1.13 Raporti Vjetor i Departamentit të Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në Universitetin e Arteve, studentët janë në qendër të procesit mësimor dhe përfshihen në çdo fazë të zhvillimit të programeve – nga prezantimi i lëndëve të mënyra e vlerësimit dhe paraqitjet përfundimtare. Procesi mësimor mbështetet në komunikim të vazhdueshëm mes studentëve dhe stafit akademik. Studentët japin vlerësim periodik për proceset akademike përmes sondazhit të studentëve, nga i cili hartohet një raport përmbledhës që adreson gjetjet përkatëse. Sipas Rregullores së programit të studimit (1.0.6, Neni 19; shih edhe Standardi V.5, Kriteri 4), ata kanë të drejtën të ankimojnë për vlerësimet e tyre. Megjithatë, GVJ gjatë takimeve nuk konstatoi raste konkrete ankimesh. Përmasat e vogla të programit krijojnë një marrëdhënie të afërt dhe komunikim të drejtpërdrejtë mes studentëve dhe stafit, gjë që ndihmon në zgjidhjen e çështjeve pa nevojën për mekanizma formalë ankimi. <i>Evidenca Nr. 1.0.1 – Statuti i Universitetit të Arteve, neni 123, pika 1 dhe 2; neni 126.</i> <i>Evidenca Nr. 5.2.4 – Pyetësori për studentët.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie	GVJ konstatoi se monitorimi i cilësisë në Universitetin e Arteve realizohet përmes pyetësorëve të studentëve, ndërsa rezultatet e mbledhura publikohen dhe shpërmdahen në disa forma. Ato prezantohen në takime informuese me studentë, staf akademik dhe administrativ, ku diskutohen gjetjet dhe


bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	propozohen përmirësime të mundshme. Departamenti kryen analiza vjetore mbi rezultatet e monitorimit, duke identifikuar pikat e forta dhe dobësitë, që ndihmojnë në hartimin e strategjive për zhvillim dhe përmirësim. Rezultatet e vlerësimit apo raportet analitike përkatëse nuk rezultojnë të aksesueshme dhe publike. Rekomandohet bërja publike e rezultateve duke shfaqur analiza të përgjithshme e duke shmangur informacione apo të dhëna që lidhen me individë. Evidencë Nr. 1.0.1 Statuti i Universitetit të Arteve – Neni 123, pika 1 dhe 2; Neni 126. Evidencë Nr. 5.25 Pyetësi për studentët.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Sondazhet dhe raportet përkatëse analizohen dhe diskutohen nga autoritetet drejtuese dhe personeli akademik duke evidentuar problematikat apo edhe praktikatat e mira. Ky proces ndikon në nxitjen e personelit akademik dhe strukturave në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky angazhim u vu re edhe gjatë takimit të GVJ-së me personelin akademik. Referenca: Shenime gjate takimeve Evidencë Nr. 1.13 Raporti Vjetor i Departamentit të Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve.			
Konkluzione	Gjatë vizitës në universitet dhe vlerësimit të dokumentacionit, GVJ vërejt një përpjekje të strukturuar dhe të vazhdueshme në përmirësimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Studentët gjithashtu janë të përfshirë dhe si aktorë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit. U konstatua se rezultatet e vlerësimeve duhet të bëhen publike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me	Gjatë takimeve të kryera, GVJ konstatoi se struktura organizative e Universitetit të Arteve është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe mbështetet në Statutin dhe aktet rregullatore të institucionit. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, funksionon NJSBC në bashkëpunim me Sektorin Mësimor dhe njësitë akademike. Detyrat përfshijnë rishikimin

parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	e akteve, zbatimin e standardeve sipas Kodit të Cilësisë, vlerësimin periodik të veprimtarive dhe mbajtjen e databazës së ish-studentëve. GJV vlerëson se ky organizim mbështet një qasje të strukturuar dhe funksionale për sigurimin e cilësisë në UART. Nga njohja e GJV me institucionin tri rezultojnë strukturat kryesore në UART që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë: - Departamenti - Sektori Mësimor - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Sipas rregullores së funksionimit të NJSBC , struktura përgjegjëse është Zyra Mësimore dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Karrierës dhe Alumnit. Kjo zyrë kryen vlerësimin dhe raportimin periodik në përputhje me standardet e cilësisë. Kjo zyrë raporton tek Zv. Rektori për anën mësimore. <i>Evidencë Nr. 6.0.5 Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.1 Statuti i UART. Neni 35</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GJV gjatë takimit me njësitë përkatëse u njoh me rolin e Njesisë Bazë, që është përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë në Universitetin e Arteve, e mbështetur nga Sektori Mësimor dhe Sekretaria Mësimore. Pas përfundimit të procesit mësimor, stafi akademik shqyrton problematikat dhe propozon ndryshime për përmirësimin e programeve. Universiteti siguron që studentët të kenë akses në pedagogë të ftuar nga institucione kulturore dhe artistike. Njësia Bazë kryen analiza të detajuara të procesit mësimor, mbështetur nga sygjërimet e stafit dhe anketimet e studentëve, dhe përcjell rezultatet në Departament dhe Dekanat për shqyrtim. Universiteti ka zhvilluar një strategji për sigurimin e cilësisë përmes përgatitjes dhe standardizimit të dokumentacionit, rregulloreve, politikave dhe procedurave, duke siguruar përmbushjen e kërkesave ligjore dhe akademike. <i>Shënime gjatë vizitës</i> <i>Evidencë Nr. 1.0.1 Statuti i UART, Kreu X, nenet 135 dhe 136.</i> <i>Evidencë Nr. 6.0.5 Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i> <i>Evidencë Nr. 3.0.9 Raporti vjetor i punës artistike, mësimore dhe shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2022–2023</i>




Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti është subjekt i akreditimeve periodike institucionale dhe programeve, një praktikë e vendosur prej disa vitesh. Raportet e vlerësimit të brendshëm hartohen si pjesë e procedurës standarde, pasuar nga raportet e vlerësimit të jashtëm. Rezultatet e akreditimeve tregojnë se universiteti ka një performancë të qëndrueshme në lidhje me cilësinë e programeve, që dëshmon masa dhe mjete efikase për Sigurimin e Cilësisë. Referenca: RVB Shënime gjatë vizitës
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Duke u bazuar në dokumentet "Evidencë Nr. 1.0.5 Rregullorja mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor e UART", "Evidencë 1.0.8 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Perkusion, "Evidencë Nr. 3.0.7 Aktivitetet artistike pedagogë, studentë, dhe Evidencë Nr. 3.0.8 Festivale, koncerte, aktivitete artistike", procesi i përmirësimit të programeve të studimit dhe mësimdhënies në Universitetin e Arteve mbështetet në një sistem rregullator të detajuar dhe të standardizuar. Gjatë takimit, GVJ konstatoi se programet rishikohen dhe përmirësohen periodikisht nga personeli akademik dhe ai i ftuar, duke u mbështetur në sygjërimet dhe vlerësimet e bëra në përputhje me këto rregullore. Gjithashtu, evidencat e lidhura me aktivitetet artistike të pedagogëve dhe studentëve, si dhe organizimin e festivaleve, koncerteve dhe aktiviteteve artistike, tregojnë angazhimin e Universitetit të Arteve për t'i siguruar studentëve mundësitë për zhvillimin dhe shfaqjen e talenteve të tyre artistike. Ky proces përmirësimi orienton vlerësimin dhe zhvillimin e metodave të mësimdhënies dhe programeve për të siguruar që ato të jenë në përputhje me kërkesat e tregut dhe standardet ndërkombëtare, duke garantuar një cilësi të lartë të arsimit dhe duke përgatitur studentët për sfidat e tregut global. Evidenca Nr. 1.0.5 – Rregullorja mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART. Evidenca Nr. 1.0.8 – Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Muzikë Jazz. Evidenca Nr. 3.0.7 – Aktivitetet artistike të pedagogëve dhe studentëve.

	Evidenca Nr. 3.0.8 – Festivale, koncerte dhe aktivitete artistike.			
Konkluzione	Politikat dhe procedurat në lidhje me Sigurimin e Cilësisë janë prezente dhe në proces konsolidimi. Të tilla praktika janë integruar në punën e përditshme të stafit akademik dhe ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Me zhvillimin e mëtejshëm të programit do të nevojitet edhe hartimi i qasjeve specifike të lidhura me natyrën e programit dhe perspektivën e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Sigurimi i cilësisë së programit është përgjegjësi e Departamentit të Interpretimit. Departamenti monitoron aktivitetin e përditshëm, kryen analiza periodike dhe iniciativat për ndryshime dhe përmirësime në strukturën dhe përmbajtjen e programit. Analiza e punës vjetore të departamentit dokumentohet përmes raporteve të departamentit. Departamenti dhe Sektori Mësimor zhvillojnë gjithashtu një analizë të sondazheve periodike mbi mësimdhënien. <i>Evidenca Nr. 5.24 – Pyetësori për studentët.</i> <i>Evidenca Nr. 6.0.3 – Pyetësori për stafin akademik.</i> <i>Evidenca Nr. 1.19 – Raporti vjetor i Departamentit të Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve.</i> <i>Evidenca Nr. 3.0.9 – Raporti vjetor i punës artistike dhe mësimore-shkencore të stafit akademik të UART për vitin akademik 2022-2023.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e	Në bazë të vlerësimit të pyetësorëve, raportet me të dhënat dhe informacionet shqyrtohen në Njësinë Bazë dhe në Rektorat. Gjithashtu, si një detyrë nga proceset e akreditimit, universiteti

vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	adreson rekomandimet e bordit të akreditimit. Analiza Vjetore e Departamentit adreson çështje si: • Veprimtaria mësimore; • Ngarkesa mësimore; • Procesi i vlerësimit të brendshëm; • Infrastruktura për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor; • Aktivitetet e realizuara; • Të tjera. Megjithëse dokumentacioni ekziston, analiza e thelluar dhe ndjekja e problematikave (rezultatet e pritura, motivimi i praktikave më të mira dhe arritjet etj.) kryhet në punën e përditshme të departamentit dhe jo përmes proceseve të dokumentuara. <i>Evidenca Nr. 1.19 – Raporti vjetor i Departamentit të Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve.</i> <i>Evidenca Nr. 6.0.6 – Modeli i vlerësimit të personelit akademik.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në bazë të dokumentacionit të siguruar dhe takimeve me studentët dhe stafin akademik, GVJ vërejti se metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit janë të aplikuara për të verifikuar përparimin e studentëve dhe performancën e tyre. Këto metoda përfshijnë provimet, projekte individuale apo ne grup, performanca dhe aktivitete artistike, frekuentimin dhe pjesëmarrjen etj. Duke pasur parasysh natyrën e veçantë të mësimdhënies në perkusion në lëndët profesionale, vlerësimi bëhet mbi punën / projektet që janë specifike për disiplinën e muzikes jazz. Këto janë të gjitha elemente që janë vlerësuar kryesisht nga stafi akademik. Një pjesë e punës së kryer është e hapur edhe ndaj vlerësimit publik (ndonëse jo zyrtar) në koncerte apo aktivitete artistike. <i>Evidenca Nr. 1.19 – Raporti vjetor i Departamentit të Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve.</i> <i>Evidenca Nr. 2.12 – Foto nga aktivitetet artistike të pavarura të studentëve.</i> <i>Evidenca Nr. 2.13 – Projektet artistike të programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Metodat indirekte të vlerësimit (kryesisht pyetësorët dhe analizat e të dhënave) përdoren për të marrë të dhëna dhe perceptime që mund të ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së përgjithshme të programit. Këto analiza dhe të dhëna

studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	ndihmojnë në identifikimin e problemeve dhe mundësive për përmirësim, bazuar në perceptimet e aktorëve të ndryshëm ose në të dhënat e siguruara nga indikatorë të matshëm. Një tjetër mënyrë e vlerësimeve indirekte është feedback-u që merret gjatë aktiviteteve artistike, koncerteve, performancave apo projekteve të bashkëpunimit me institucionet e ndryshme kulturore. Ekspozimi i punës së studentëve ndaj një komuniteti më të gjerë se ai akademik është një praktikë e mirë dhe e domosdoshme për natyrën e programit të studimit.			
	<i>Evidencë Nr. 2.12 Rregullorja mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor e UART</i> <i>Evidencë 1.0.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Perkusion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vërejtë se departamenti dhe strukturat e universitetit të lidhura me Sigurimin e Cilësisë, kryejnë një përpjekje të vazhdueshme për të monitoruar dhe kontrolluar cilësinë e programit. Instrumentat dhe praktikat e përdorura janë duke u konsoliduar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe në bashkëbisedim me zyrën përkatëse, GVJ u njoh me funksionimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve. U evidentua se procesi i sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshin aktivisht si aktorët e brendshëm, ashtu edhe ata të jashtëm. Pedagogët e jashtëm bashkëpunojnë ngushtësisht me njësitë përkatëse akademike për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të cilësisë, në përputhje me standardet dhe kriteret institucionale. Gjithashtu, GVJ u informua se studentët kanë rol të drejtpërdrejtë në këtë proces

	përmes përfaqësimit të tyre dhe pjesëmarrjes në vlerësimet periodike të cilësisë. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të Statutit dhe rregulloreve përkatëse të universitetit, duke garantuar përfaqësimin e strukturave akademike dhe administrative në Komisionin përkatës (KSBC), përfshirë edhe një përfaqësues studentor, siç përcaktohet në nenet 135 dhe 136 të Statutit të Universitetit. Evidencë Nr. 1.O.1 Statuti i UART, neni 353 123 Evidencë Nr. 6.0.5 Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Referuar të njëjtës rregullore (shih më sipër), Neni 6, NJSBC ka këto detyra. - Mbledh të dhënat sipas treguesve sasiorë dhe cilësorë për institucionin dhe programin e studimit; - Organizon vlerësimin e vazhdueshëm periodik të SC; - Krijon një sistem dokumentacioni për SC, duke përditësuar procedurat e ndryshme; - Përmirëson metodologjinë e punës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave; - Bën vlerësimin për stafin akademik; - Bën përpunimin e pyetësorëve; - Nxit pjesëmarrjen dhe angazhimin për zbatimin e rekomandimeve përmes plan-veprimeve; - Bashkërendon dhe asiston procesin e vlerësimit të brendshëm; - Merr pjesë në GVB; - Ruan dhe përmirëson njohuritë teknike përmes trajnimeve; - Harton çdo 2 vite RVB në nivel institucional; - Etj. GVJ konstatoi se këto procese kryhen nga NJSBC, edhe pse një pjesë e tyre nuk janë gjithmonë të dokumentuara përmes raporteve dhe evidencave. Gjithsesi, praktikat vlerësohen të vendosura dhe në proces konsolidimi. Përtej NJSBC, Departamenti dhe Sektori mësimor kanë peshën dhe detyrat kryesore në rutinën e mbarëvajtjes dhe SC për programin e studimit. <i>Evidencë Nr. 1.O.1 Statuti i UART neni 35 pika 1.</i> <i>Evidencë Nr. 6.0.5 Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i> <i>Evidencë Nr. 5.23 Rregullore e funksionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni</i>




Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Raporti i vlerësimit të brendshëm, pjesë e vlerësimit të cilësisë së programit, është përgatitur nga një grup i përbërë nga 5 persona që përfaqësojnë Departamentin e Interpretimit, administratën e universitetit dhe studentët. Të gjithë anëtarët e grupit kanë marrë pjesë në mbledhjen e të dhënave, analizën dhe hartimin e raportit, sipas pozicionit dhe kompetencave të tyre. Angazhimi i aktorëve dhe palëve të interesuara është ilustruar gjithashtu në Kriterin 1 të këtij standardi.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Gjatë vizitës në universitet dhe takimeve të ndryshme që u mbajtën, GVJ konstatoi mungesën e çdo shenje diskriminimi, pabarazie apo sjelljeje që nuk i përket etikës akademike. Një ambient gjithëpërfshirës, harmonik dhe respektues u perceptua si ndër studentët ashtu edhe ndër stafin akademik.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk kemi evidenca për angazhimin e drejtpërdrejtë të ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Siç përmendet më sipër, referuar rregullores së NJSBC në rastet kur ka akreditime për herë të parë apo institucionale, thirret një ekspert i jashtëm. Gjithashtu, angazhimi i pedagogëve të jashtëm, të lidhur drejtpërdrejt me tregun e punës jep një feedback të vazhdueshëm për politikën dhe qasjet e institucionit në drejtimin e SBC. Po ashtu përmes kontakteve me universitete të huaja mundësohet shkëmbimi i eksperiencave të mira dhe marrja e feedback-ut. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm si pjesë e përhershme dhe zyrtare e strukturave të SBC do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale.
Konkluzione	<i>Gjatë punës vëzhguese dhe takimeve të zhvilluara, GVJ konstatoi një mjedis institucional ku ndërveprimi mes aktorëve të brendshëm të përfshirë në procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zhvillohet në mënyrë të barabartë, të hapur dhe pa forma diskriminimi apo përjashtimi. Strukturat dhe procedurat ekzistuese mundësojnë pjesëmarrjen aktive të stafit akademik, administrativ dhe studentëve, duke krijuar një bazë të shëndoshë për reflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm të</i>

	<i>cilësisë në procesin arsimor dhe në administrimin e programeve të studimit.</i> <i>Megjithatë, GVJ thekson se për të forcuar më tej këtë proces dhe për të përmbushur në mënyrë më të plotë kërkesat për transparencë dhe përfaqësim gjithëpërfshirës, është e nevojshme të intensifikohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm. Konkretisht, përfshirja më e rregullt dhe e strukturuar e përfaqësuesve të alumni-t, ekspertëve të jashtëm dhe përfaqësuesve të tregut të punës në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), si dhe në procese të tjera vlerësimi dhe planifikimi, do të ndihmonte në pasurimin e perspektivës dhe do të siguronte një lidhje më të fortë midis universiteteve dhe realitetit profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në përgjithësi, GVJ konstatoi një nivel transparence dhe komunikimi të mirë brenda universitetit. Një pjesë e mirë e dokumentacionit, rregulloreve dhe informacionit aksesohet lehtësisht online përmes faqes web. UART përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi. http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=292&niveli=85 http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=6&niveli=25
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Meqenëse ky është akreditimi i parë për programin e studimit GVJ, nuk u gjetën informacione publike mbi rezultatet e vlerësimeve periodike. Raportet Vlerësuese të Brendshme (RVB/RVJ) për programet e tjera të studimit, si edhe rezultatet përkatëse të vlerësimeve apo raportet analitike, nuk janë të aksesueshme publikisht. Përtej dokumenteve të vëna në dispozicion dhe RVB-së, mungojnë të dhëna shtesë të hapura për publikun që lidhen me performancën dhe ecurinë e programeve të tjera. Në vijim të procesit të akreditimit, rekomandohet që të bëhen publike raportet e hartuara për këtë program (përfshirë këtë RVJ), si dhe rezultatet e pyetësorëve, duke ofruar analiza të përgjithshme dhe duke shmangur çdo të dhënë që lidhet me individë.

	<i>Evidencë Nr. 1.0.1 – Statuti i Universitetit të Arteve, Neni 76</i> <i>Evidencë Nr. 6.0.5 – Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidencë Nr. 5.23 – Rregullore e Funkcionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ u njoh me procedurat dhe masat që Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, ndjek për të adresuar problematikat e evidentuara nga raportet vjetore, sondazhet dhe pyetësorët. Këto instrumente shoqërohen gjithmonë me analizë të rezultateve dhe plan masash konkrete për përmirësimin e aspekteve të dobëta. Në rastin e vlerësimit të programeve për akreditim, grupi i punës për vlerësimin e brendshëm harton një seri ndërhyrjesh të orientuara drejt zgjidhjeve efektive dhe të përkohshme.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Duhet theksuar se sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UA është i ngritur në aspektin formal dhe është relativisht i konsoliduar. Departamenti menaxhon dhe monitoron ecurinë e programit të studimit dhe kryen punë të vazhdueshme në zhvillimin e tij. Procesi i parë i akreditimit (hartimi i RVB dhe RVJ) është në thelb hapi fillestar në vlerësimin e gjithanshëm të këtij programi, i cili deri tani rezulton të jetë integruar mjaft mirë në ofertën akademike të UA.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë takimit, GVJ u njoh me organizimin e sektorit Mësimor dhe Kurrikulës (NJSBC), i cili zhvillon sesione për të informuar dhe sensibilizuar stafin dhe studentët për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. GVJ u njoh me aktivitetet të cilat përfshijnë takimet e zhvilluara për ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe zhvillimin e anketave në lidhje dhe me programin e studimit "Perkusion", me vlerësime të mbështetura në dokumentat konkrete. <i>Evidenca Nr. 6.16 – Foto nga sesionet informuese.</i> <i>Evidenca Nr. 5.24 – Pyetësori për studentët.</i> <i>Evidenca Nr. 6.0.3 – Pyetësori për stafin akademik.</i>
Konkluzione	<i>Politikat dhe procedurat për Sigurimin e Cilësisë janë të pranishme dhe janë në fazë konsolidimi, duke u integruar gradualisht në praktikën e përditshme të stafit akademik. Këto politika kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programeve dhe shërbejnë si udhëzues për monitorimin e cilësisë. GVJ konstatoi se strukturat përkatëse të universitetit janë angazhuar në mënyrë të qëndrueshme për të monitoruar cilësinë, duke krijuar një mjedis bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës, ku të gjitha palët e përfshira kontribuojnë për zhvillimin e një procesi edukativ cilësor. Megjithatë, është e</i>

	<i>nevojshme të theksohet se duhet të zhvillohen qasje më të përshtatura dhe të personalizuarra për natyrën e veçantë të programeve të studimit. Për më tepër, do të ishte e dobishme përfshirja e ekspertëve të jashtëm në strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në proceset përkatëse për të siguruar një vlerësim të pavarur dhe më të plotë të performancës dhe ecurisë së programeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Perkusion” të ofruar nga “Universiteti I Arteve”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi fokusohet në zhvillimin individual të çdo studenti, duke ndërtuar një qasje që respekton kohën, potencialin dhe prijet e secilit. Përmes një kombinimi ndërmjet trajnimit teknik rigoroz dhe lirisë kreative, studentët inkurajohen të forcojnë aftësitë e tyre interpretative, të eksplorojnë gjuhën personale artistike dhe të ndërtojnë një identitet të qëndrueshëm muzikor. Çdo komponent i programit është projektuar për të mbështetur shprehjen autentike dhe për të nxitur pavarësinë artistike, duke ofruar një mjedis të sigurt ku studentët mund të eksperimentojnë, të reflektojnë dhe të rriten si interpretë profesional. Kjo qasje i përgatit jo vetëm për performancën në skenë, por edhe për të qenë kontribuues të denjë në jetën kulturore bashkëkohore. Përmes këtij programi, studentët fitojnë kompetenca të avancuara profesionale dhe artistike, duke zhvilluar aftësi për krijimin, interpretimin dhe përvetësimin e njohurive të reja, si dhe për aplikimin e metodave bashkëkohore në veprimtarinë e tyre artistike.
2. Programi mbështetet nga një trup akademik me eksperiencë të konsoliduar, me kontribute të njohura në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e interpretimit dhe krijimtariisë muzikore. Në qendër të tij qëndron thellimi personal i studentëve në disiplinën e përzgjedhur dhe nxitja e bashkëpunimit ndërdisiplinor, duke krijuar ura ndërmjet disiplinave të ndryshme artistike dhe zgjeruar horizontet e tyre akademike.
3. Diplomantët e këtij programi kanë mundësi të angazhohen në institucione të kulturës dhe artit, përfshirë orkestrat simfonike, grupet e perkusionit, orkestrat frymore, si dhe në shkolla artistike dhe ansamble muzikore në nivel qendror dhe lokal. Duke qenë se mungon një program i specializuar për perkusionin në Shqipëri, ky program ofron një potencial të veçantë për punësim, duke përmbushur një nevojë konkrete në tregun artistik dhe kulturor.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e angazhimit të stafit akademik dhe studentëve në programet ndërkombëtare si Erasmus+ paraqet një pengesë për ndërkombëtarizimin e programit dhe përfitimin nga përvoja akademike dhe artistike jashtë vendit (**Standardi III.1 - Kriteri**). Përfshirja në këto programe do të mundësonte shkëmbime të vlefshme kulturore, profesionale dhe akademike, duke rritur cilësinë e mësimdhënies dhe perspektivat e karrierës për studentët.

Rekomandime:

1. Rekomandohet që të krijohen mundësi për pjesëmarrjen e stafit në ngjarje artistike dhe shkencore, duke ofruar mbështetje financiare dhe organizative. Kjo mund të përfshijë sigurimin e fondeve për udhëtimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete të jashtme, si dhe organizimin e ngjarjeve brenda institucionit që do të mundësonin shkëmbimin e



eksperiencave. Gjithashtu, është e rëndësishme të nxisen dhe të vlerësohen iniciativat personale të stafit për të krijuar dhe përfshirë në projekte artistike dhe shkencore, duke u ofruar mundësi për të udhëhequr ose për të kontribuar në to.

2. Rekomandohet të mbështetet, stimulohet dhe të iniciohet organizimi i leksioneve të hapura, me përfshirjen e tematikave shkencore dhe teorike në muzikë. Ky proces mund të nxisë një ekuilibër midis praktikës dhe teorisë, duke inkurajuar si stafin akademik, po ashtu edhe studentor.
3. Rekomandohet ndërmarrja e hapave për të krijuar ose zgjeruar marrëdhëniet me institucione akademike të huaja mund të rrisë mundësitë për angazhimin e studentëve dhe stafit në projekte dhe shkëmbime ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrja e stafit dhe e studentëve në programet Erasmus. Kjo mund të përfshijë mundësi për kreditim të aktiviteteve ndërkombëtare si pjesë e aktivitetit akademik.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Percussion" provided by the Higher Education Institution "University of Arts"

Strengths and affirmations

1. The program focuses on the individual development of each student, building an approach that respects their knowledge, potential, and tendencies. Through a combination of rigorous technical training and creative freedom, students are encouraged to strengthen their interpretative skills, explore their personal artistic language, and build a sustainable musical identity. Each component of the program is designed to support authentic expression and foster artistic independence, providing a safe environment where students can experiment, reflect, and grow as professional performers. This approach prepares them not only for stage performance but also to be valuable contributors to contemporary cultural life. Through this program, students gain advanced professional and artistic competencies, developing skills for creating, interpreting, and acquiring new knowledge, as well as applying contemporary methods in their artistic activities.
2. The program is supported by an experienced academic staff with well-established contributions to both the national and international stages in the fields of performance and music. At its core, it focuses on the personal development of students in their chosen discipline and encourages interdisciplinary collaboration, creating bridges between different artistic fields and broadening their academic horizons.
3. Graduates of this program have the opportunity to engage with cultural and artistic institutions, including symphonic orchestras, percussion groups, wind ensembles, as well as in artistic schools and musical ensembles at both central and local levels. Since there is a lack of a specialized percussion program in Albania, this program offers unique employment potential by addressing a concrete need in the artistic and cultural market.

Weaknesses

1. Regarding the scientific activity at the program level, it has been noted that no open lectures have been held to directly address theoretical and research topics in the field of



music. This could be related to the lack of a defined structure for organizing such activities or to the staff's increased focus on the practical and performative aspects of student training (**Standardion III.1 -Criterion**). The lack of engagement of academic staff and students in international programs such as Erasmus+ presents an obstacle to the internationalization of the program and to benefiting from academic and artistic experiences abroad. Participation in these programs would facilitate valuable cultural, professional, and academic exchanges, enhancing the quality of teaching and career prospects for students.

Recommendation

1. It is recommended to create opportunities for staff participation in artistic and scientific events by offering financial and organizational support. This could include securing funding for travel and participation in external activities, as well as organizing events within the institution that could enable the exchange of experiences. Additionally, it is important to encourage and value the personal initiatives of staff to create and participate in artistic and scientific projects, offering them opportunities to lead or contribute to such projects.
2. It is recommended to support, stimulate, and initiate the organization of open lectures, including scientific and theoretical topics in the field of music. This process could encourage a balance between practice and theory, motivating both academic staff and students.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X